



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjensia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim (SDC)

INSTAT
Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

MIGRACIONI NË SHQIPËRI

MAJ, 2014



MIGRACIONI NË SHQIPËRI

Maj, 2014

Drejtor Botimi:

Dr. Gjergji FILIPI

INSTAT

Emira Galanxhi

Majlinda Nesturi

Ledia Thomo

ASISTENCA TEKNIKE

Elira Jorgoni

Didier Ruedin

Copyright © INSTAT 2014

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizim paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.



INSTITUTI I STATISTIKAVE

Blv. "Zhan D'Ark" Nr. 3, Tiranë

Tel : + 355 4 2222411 / 2233356

Fax : + 355 4 2228300

E-mail : info@instat.gov.al

Shtypshkronja: GENTGRAFIK

Parathënie dhe falenderime

Censusi i Popullsisë dhe Banesave në vitin 2011 në Shqipëri, është i 11-i i kryer në historinë e censuseve të Shqipërisë. Përgatitja dhe zbatimi i këtij angazhimi kërkon një sasi të konsiderueshme burimesh financiare dhe njerëzore. Për këtë, INSTAT ka përfituar nga mbështetja e Qeverisë Shqiptare, Bashkimit Evropian dhe donatorëve ndërkombëtarë. Metodologjia e censurit është e bazuar në rekomandimet e EUROSTAT-it dhe të OKB-së për censuset e popullsisë dhe banesave të vitit 2010, duke marrë në konsideratë nevojat e veçanta të përdoruesve shqiptarë për të dhëna specifike.

INSTAT në bashkëpunim të ngushtë me donatorët e huaj ka iniciuar një proces analizimi më të thelluar të të dhënave të censurit, duke i krahasuar ato edhe me tregues të tjerë administrativë apo anketa të ndryshme. Analizat e thelluara të censurit të popullsisë dhe banesave 2011 do të shërbejnë më së miri në të ardhmen për të kuptuar dhe interpretuar më saktë karakteristikat e shoqërisë shqiptare. Informacioni që mbledhet nga censusi është multidimensional dhe në këto analiza shpreh disa risi si: tregu shqiptar i punës dhe struktura e tij, dinamikat e migracionit, tipologjia e ndarjes administrative, projeksionet e popullsisë si dhe karakteristikat e banesave dhe kushteve të banimit.

Seria e këtyre publikimeve ofron një pasqyrim të ri të gjendjes së shoqërisë shqiptare duke ndihmuar në kuptimin e mënyrave se si mund të investohet në infrastrukturë, si të ndihmohen autoritetet lokale nëpërmjet fenomeneve të urbanizimit duke patur parasysh ritmet e rritjes së popullsisë në të ardhmen, apo si të adresohen politikat në tregun e punës etj.

Të pesë botimet e kësaj serie janë analiza të thelluara të kryera nga INSTAT në bashkëpunim me Universitetin e Gjenevës, Universitetin e Neuchâtel dhe Institutin të Kërkimeve Urbane, dhe të mbështetura financiarisht nga SDC-Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

INSTAT gjen rastin të shprehë mirënjohje dhe falenderime për kontributin e çmuar të SDC- Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, ekspertëve të INSTAT dhe ekspertëve të tjerë vendas dhe të huaj në publikimin e serisë së analizave të censurit të popullsisë dhe banesave 2011.

Një falënderim i veçantë shkon për të gjithë institucionet dhe donatorët, të cilët kanë kontribuar në realizimin e censurit të popullsisë dhe banesave 2011, Qeverinë Shqiptare, Bashkimin Evropian (IPA 2009 dhe CARDS 2006), SIDA - Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar, SDC- Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, UNFPA - Fondin e Kombeve të Bashkuara për Popullsinë dhe UNDP - Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim.

Dr. Gjergji FILIPI

Drejtor i Përgjithshëm i INSTAT



Lista e publikimeve tematike të Censurit 2011, Maj 2014

List of 2011 Census thematic publications, May 2014

- Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011: karakteristikat ekonomike
- 2011 Population and Housing Census: Economic Characteristics
- Dimensionet e cilësisë së Censurit 2011
- Quality Dimensions of the 2011 Population and Housing Census of Albania
- Kushtet e banimit dhe të jetesës
- Dwelling and living conditions
- Migracioni në Shqipëri
- Migration in Albania
- Një klasifikim i ri urban - rural i popullsisë shqiptare
- A new urban - rural classification of Albanian population
- Popullsia dhe dinamikat e saj - horizonte të reja demografike?
- Population and population dynamics in Albania - New demographic horizons?
- Projeksionet e popullsisë, 2011-2031
- Population Projections, 2011-2031
- Shqipëria 2011 Censusi në harta
- Albania 2011 Census Atlas
- Tipologjia e komunave dhe bashkive
- Communes and Municipalities Typology
- Lëvizjet vajtje-ardhje për qëllime punësimi
- Commuting from home to work
- Dinamikat e tregut të punës, 2001-2011
- Labour market dynamics, 2001-2011
- Aplikimi INSTATGIS – hartat në web (www.instatgis.gov.al)
- INSTATGIS – Atlas web application (www.instatgis.gov.al)

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	9
Vështrim i përgjithshëm	11
2. MIGRACIONI I BRENDSHËM	12
Gjeografia e migracionit të brendshëm.....	12
Dinamikat e migracionit të brendshëm	22
Karakteristikat e migrantëve të brendshëm	25
Modeli individual	28
3. MIGRACIONI NDËRKOMBËTAR.....	31
Emigracioni	31
Strukturat e emigracionit	35
Migracioni i kthimit	37
Të huajt në Shqipëri.....	42
4. NDIKIMI I MIGRACIONIT	43
Dërgesa në para nga jashtë	43
Fokusi në Tiranë.....	45
Fëmijët dhe ndikimi social i migracionit	46
Varfëria dhe struktura e NjEF-ve sipas statusit të migracionit	49
5. PËRFUNDIME	51
6. SHTOJCË	52
7. REFERENCA.....	61
8. BIBLIOGRAFI SHITESË	63

Lista e figurave

Figura 1: Raporti i migrantëve të brendshëm të ardhur në gjashtë komunat/bashkitë përreth Tiranës sipas qarkut të origjinës, në (%)	15
Figura 2: Raporti i migrantëve të brendshëm në gjashtë komunat/bashkitë përreth Tiranës sipas qarkut të origjinës, në (%)	16
Figura 3: Rritja e popullsisë në periudhën 2001-2011	17
Figura 4: Dinamikat e migracionit të brendshëm	22
Figura 5: Migrantët e brendshëm të cilët lëvizin direkt në qarkun e tyre të fundit të vendbanimit, në (%)	23
Figura 6: Migrantët e brendshëm të cilët ndryshojnë rrethin të paktën dy herë përpara mbërritjes në vendbanimin e fundit, në (%)	24
Figura 7: Migrantët e brendshëm, që ndryshojnë qarkun kundrejt atyre që lëvizin brenda të njëjtit qark, në (%)	24
Figura 8: Migrantët e brendshëm sipas grupmoshës dhe gjinisë, 2001-2011	25
Figura 9: Migrantët e brendshëm sipas grupmoshës dhe gjinisë, 1989-2001	26
Figura 10: Migrantët e brendshëm sipas statusit civil	26
Figura 11: Arsyeja kryesore e migracionit të brendshëm sipas gjinisë, në (%)	27
Figura 12: Migrantët e brendshëm sipas grupmoshës dhe arsyes kryesore të migrimit, në (%)	27
Figura 13: Migrantët e brendshëm sipas nivelit arsimor dhe gjinisë, në (%)	28
Figura 14: Modeli individual, 2001-2011	29
Figura 15: Modeli individual, 1989-2001	30
Figura 16: Llogaritja indirekte: Struktura moshore e meshkujve	31
Figura 17: Llogaritje indirekte: Kalimi në datën e censusit	32
Figura 18: Krahësimi i popullsisë së projektuar dhe asaj të censusit	32
Figura 19: Llogaritje indirekte: Migracioni neto dhe numri i migrantëve të kthyer, sipas grupmoshës dhe gjinisë	33
Figura 20: Vlerësim i tërthortë: Mosha dhe gjinia e numrit të emigrantëve	33
Figura 21a: Piramida e popullsisë së emigrantëve, 1989 – 2001	34
Figura 21b: Piramida e popullsisë së emigrantëve, 2001 – 2011	34
Figura 22: Popullsia më 1 tetor 2011 me dhe pa emigracionin	35
Figura 23: Numri i shqiptarëve jashtë vendit, 2011	36
Figura 24: Flukset dalëse të shqiptarëve drejt vendeve të përzgjedhura të OECD-së, 2005 – 2011	36
Figura 25: Migrantët e brendshëm dhe migrantët e kthyer sipas grupmoshës, në (%)	37
Figura 26: Numri i migrantëve të kthyer sipas grupmoshës dhe gjinisë	38

Figura 27: Arsyet e kthimit, në (%).....	38
Figura 28: Migrantët e kthyer sipas nivelit arsimor dhe vitit të kthimit, në (%)	39
Figura 29: Numri i migrantëve të kthyer, 2001 – 2011	39
Figura 30: Numri i migrantëve të kthyer nga Greqia, Italia, Gjermania sipas vitit të kthimit	40
Figura 31: Migrantët e kthyer sipas vendbanimit të zakonshëm në vitin 2001, në (%)	40
Figura 32: Shtetasit e lindur jashtë vendit sipas grupmoshës.....	42
Figura 33: Dërgesat në para nga jashtë vendit, 1992 – 2013, në milionë dollarë amerikanë.....	43
Figura 34: Dërgesat në para nga jashtë në 2011 sipas vendit të emigrimit, në (%)	44
Figura 35: Fluksi i dërgesave në para nga jashtë në NjEF gjatë vitit 2012 dhe statusi i punësimit i emigrantëve aktualë, në (%).....	44
Figura 36: Vendbanimi dhe rajoni i anëtarëve të NjEF-së që nuk jetojnë aktualisht në NjEF, në (%)	47
Figura 37: Bashkëshorti/ja dhe fëmijët gjatë periudhës së migracionit, në (%)	48
Figura 38: Bashkëshorti(ja) /partneri(ja) dhe fëmijët e migrantëve aktualë, në (%)	48
Figura 39: Indikatorët e varfërisë sipas statusit të migrimit, 2005 dhe 2012, në (%).....	49
Figura 40: Aksesit i NjEF-ve në kujdesin shëndetësor, sipas statusit të migracionit të anëtarëve, në (%)	50
Figura 41: Normat e ndryshimit të flukseve emigratore në Itali dhe Greqi, 2005-2011, në (%)	52
Figura 42: Numri i migrantëve të kthyer me nivel arsimor universitar, 2001-2011.....	52
Figura 43: Popullsia banuese e lindur në Greqi, sipas moshës dhe gjinisë	53

Lista e tabelave

Tabela 1. Struktura moshore dhe koeficienti i varësisë në 6 komunat/bashkitë rreth Tiranës, 2001 dhe 2011	17
Tabela 2. Matrica e migracionit të brendshëm	19
Tabela 3: Ndjekja e shkollës dhe alfabetizmi	45
Tabela 4: NjEF-të me një prind, në (%)	46
Tabela 5: Popullsia banuese e cila ka ndryshuar vendbanimin e zakonshëm, 2010-2011	53
Tabela 6: Raporti i emigrantëve ndaj popullsisë së mbyllur, 2011, në (%).....	54
Tabela 7: Stoku i Shqiptarëve jashtë vendit, sipas shtetit të vendbanimit	54
Tabela 8: Karakteristikat e NjEF-ve nga të cilat të paktën një prej pjestarëve të mëparshëm ka emigruar, në (%)	55
Tabela 9: Vendbanimi dhe rajoni i NjEF-ve sipas statusit të migrimit, në (%)	56
Tabela 10: Kuartilet e konsumit mujor për NjEF sipas statusit të migrimit, në (%)	56

Tabela 11: Karakteristikat e emigrantëve aktualë dhe NjEF-ve të tyre	57
Tabela 12: Karakteristikat e emigrantëve të kthyer dhe NjEF-së origjinë.....	58
Tabela 13: Njësitë ekonomike familjare dhe numri i anëtarëve të NjEF-së sipas bashkisë/komunës dhe llojit të NjEF-së	58
Tabela 14: Bërthamat familjare dhe anëtarët sipas bashkisë/komunës dhe llojit të bërthamës familjare	59
Tabela 15: Banesat e banuara sipas bashkisë /komunës, sistemit të furnizimit me ujë dhe llojit të tualetit	59
Tabela 16: Numri i NjEF-ve sipas bashkisë/komunës dhe statusit të pronësisë së banesës.....	60

Lista e hartave

Harta 1. Shpërndarja e popullsisë, 2011	10
Harta 2: Ndryshimi i popullsisë, 2001 – 2011	13
Harta 3: Ndryshimi i popullsisë në disa komuna/bashki rreth Tiranës, 1989 – 2001 dhe 2001 – 2011	14
Harta 4: Norma e lëvizjeve sipas qarkut	18
Harta 5: Lëvizjet e brendshme sipas qarkut të destinacionit	20
Harta 6: Lëvizjet e brendshme sipas qarkut të origjinës	21
Harta 7: Migrantët e kthyer sipas qarkut dhe vendit të emigrimit	41
Harta 8. Ndryshimi i popullsisë, 1989 – 2011	60

1. HYRJE


Gjatë dy dekadave të fundit, Shqipëria ka përjetuar një ndryshim të dukshëm të popullsisë. Jo vetëm që popullsia banuese ka pësuar rënie nga 3.182.417 në vitin 1989 në 2.800.138 në vitin 2011, por një pjesë e konsiderueshme e popullsisë ka lëvizur brenda Shqipërisë. Krahësuar me një dekadë më parë, 10 përqind e popullsisë jeton tashmë në një qytet apo fshat tjetër. Ashtu siç ndodh zakonisht me migracionin, disa grupe të shoqërisë kanë prirje më të madhe për të lëvizur duke dhënë një impakt me efekte që kanë shtrirje të gjerë në përbërjen e popullsisë në zona të ndryshme të Shqipërisë.

Ashtu si në vende të tjera me të ardhura të mesme, migracioni i brendshëm në Shqipëri është më së shumti sinonim i urbanizimit. Pjesa më e madhe e njerëzve që kanë ndryshuar vendbanimin në dy dekadat e fundit kanë lëvizur në qendrat urbane, që në shumicën e rasteve, përfshin kryeqytetin, Tiranën, ose zonat përreth tij (shih Harta 1). Të dhënat nga censusi i vitit 2011 paraqesin një tablo të detajuar të modelit të lëvizjes dhe ndikimit të migracionit në shoqëri, në lidhje me zhvillimet dhe përbërjen demografike. Kjo vërtetohet veçanërisht kur përdorim të dhëna shtesë, si ato nga Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (AMNJ), për të plotësuar tablonë që ofron censusi. Në këtë kuptim, analiza në këtë vëllim përbën një pikënisje për të kuptuar më mirë mënyrën e lëvizjes së popullsisë shqiptare dhe mënyrën si ndikon kjo e fundit jo vetëm tek migrantët por dhe tek popullsia që lënë pas.

Censusi nuk jep vetëm një tablo të hollësishme të ndryshimit të popullsisë, por ofron edhe tregues lidhur me arsyen pse njerëzit lëvizin apo përse kthehen në Shqipëri, pasi kanë kaluar një periudhë kohe jashtë vendit. Njerëzit lëvizin për punësim dhe studim në kërkim të një jetese më të mirë. Duke qenë se pjesa më e madhe e migracionit nxitet nga arsye familjare, ka tregues të qartë se ndryshimet e konstatuara priren të jenë më të përhershme, duke shkuar përtej migracionit të punësimit afatshkurtër. Pavarësisht nga arsyet individuale për të lëvizur, shkalla e migracionit në Shqipëri ka lënë një shenjë të dukshme në shumë aspekte të jetës së përditshme. Nga njëra anë, disa zona e kanë humbur pjesën më të madhe të popullsisë gjatë një dekade, ndërsa nga ana tjetër, ka qytete e fshatra ku popullsia është rritur në mënyrë të shumëfishtë. Këto ndryshime kaq të shpejta kanë një ndikim të menjëhershëm mbi infrastrukturën dhe ofrimin e shërbimeve jetësore, si kujdesi shëndetësor ose arsimi, etj.

Në të njëjtën kohë që një pjesë e konsiderueshme e popullsisë ka ndryshuar vendbanim, shumë shqiptarë kanë ikur jashtë në kërkim të një jete më të mirë. Greqia dhe Italia vazhdojnë të tërheqin deri më tani, numrin më të madh të emigrantëve shqiptarë. Tashmë, është e qartë se emigracioni nuk ka qenë i jashtëzakonshëm, siç thuhej shpesh në lidhje me valët e emigracionit të vitit 1991 dhe, në një shkallë më të vogël, për atë të vitit 1997. Emigracioni është bërë pjesë përbërëse e projekteve jetësore të individëve dhe familjeve të tyre edhe pse situata ekonomike e politike mund të jetë faktor klasik nxitjeje, ajo nuk arrin të shpjegojë flukset e vazhdueshme emigruese që mund të vëzhgohen. Një qasje më e përshtatshme do të ishte përqendrimi tek ambiciet dhe aftësitë e individëve për të migruar (de Haas 2010; de Haas 2011). Ambicia për të emigruar nxitet nga dëshira për të përmirësuar jetesën, si edhe nga informacioni rreth situatës në vende të tjera. Në këtë kuadër, ndjekja e përhapur e televizionit italian përpara vitit 1989 ka të ngjarë të ketë rritur ambiciet për të emigruar, përpara se kjo të ishte e mundur për shumicën e popullsisë.

Harta 1. Shpërndarja e popullsisë, 2011



Shënim: një pikë u korrespondon 2.500 personave.

Në të kundërt, aftësia për të lëvizur nuk varet thjesht nga heqja e kufizimeve formale për të udhëtuar, por edhe nga financat individuale, rrjeti personal dhe lidhjet e reduktuara me komunitetin lokal, që kanë ardhur si rrjedhojë e familjeve më të vogla dhe largimit të të tjerëve në komunitet. Financat individuale janë të rëndësishme, duke qenë se çdo zhvendosje sjell kosto të drejtpërdrejta dhe bart rreziqe për kosto të tërthorta shtesë. Rrjeti personal mund të ndihmojë për zvogëlimin e rreziqeve të tilla, duke siguruar punësim ose duke ofruar kontakte përcaktuese për këtë qëllim. Rrjetet personale janë parë, gjithashtu, si të rëndësishme për të ndihmuar në kapërcimin e burokracive në Itali dhe Greqi (Mai dhe Paladini 2013). Me familje më të vogla, vendimi për të lëvizur jashtë vendit mund të jetë bërë më i lehtë dhe me largimin e secilit individ ose familjeje nga komuniteti trysnia për të qëndruar është ulur. Edhe pse kjo nuk çon domosdoshmërisht në shpërbërje të komuniteteve, vendimi për t'u larguar mund të bëhet më i lehtë për individët e përfshirë.

Duke marrë në konsideratë ambiciet dhe aftësitë, mund të kuptojmë pse emigracioni nga Shqipëria nuk ka qenë kaq i jashtëzakonshëm, siç trajtohej ndonjëherë në vitet '90 dhe pse pritet të vazhdojë në të ardhmen e afërt. Gjendja ekonomike në Itali e Greqi ka gjasa të ketë ndikim të dukshëm mbi numrin e shqiptarëve që emigrojnë, por ndikimi në lëvizjet e brendshme mund të jetë vetëm i tërthortë. Me migracionin që parashikohet të vazhdojë, qoftë në nivel të brendshëm apo ndërkombëtar, ndikimi i tij mbi shoqërinë shqiptare do të vijojë.

Vështrim i përgjithshëm

Ky raport është strukturuar në tri pjesë, për të dhënë një vështrim të gjithanshëm të migracionit në Shqipëri. Seksioni i parë trajton migracionin e brendshëm – lëvizjet që ndodhin brenda Shqipërisë. Ne kemi përshkruar gjeografinë e migracionit të brendshëm, duke vënë në dukje lidhjen që ka ai me urbanizimin dhe tiparet demografike të migrantëve të brendshëm. Për të përmbledhur domethënien e këtyre tipareve individuale si dhe për të kuptuar strukturën e lëvizjes së brendshme është përdorur një model regresioni në nivel individual. Seksioni i dytë përqendrohet te migracioni ndërkombëtar – lëvizjet drejt dhe nga vende të tjera. Ne kemi bërë një përlllogaritje indirekte të numrit të emigrantëve, në përpjekje për të matur këtë pjesë të popullsisë në thelb të pamatshme. Profilet e migrantëve të kthyer dhe të huajve me vendbanim në Shqipëri plotësojnë vështrimin mbi migracionin ndërkombëtar. Seksioni i tretë trajton ndikimin e migracionit, duke marrë në konsideratë ndikimin mbi zhvillimin dhe strukturën e njësisë ekonomike familjare.

2. MIGRACIONI I BRENDSHËM

Përpara ndryshimit të regjimit, të gjitha llojet e lëvizjeve migratore në Shqipëri ishin të rregulluara në mënyrë rigorozë e të kufizuara, përfshi migracionin brenda vendit. Me kalimin në një ekonomi të hapur tregu, lëvizja e brendshme në vitet '90 u rrit në mënyrë dramatike. Kjo rritje e lëvizshmërisë i atribuohet përgjithësisht kërkesës së papërmbyshur për një lëvizje të lirë dhe Shqipëria u kthye në kuptimin e plotë në një 'vend në lëvizje' (Carletto dhe të tjerët, 2004), qoftë sa i takon migracionit të brendshëm, ashtu edhe atij ndërkombëtar. Ashtu si në vende të tjera në tranzicion, edhe në Shqipëri të dyja dukuritë janë të lidhura ngushtë. Intensiteti, drejtimi dhe arsyet që çojnë drejt këtyre lëvizjeve ndikohen nga zhvillimet ekonomike, politike e shoqërore që kanë ndodhur me kalimin e kohës në Shqipëri (Doka 2005; Vullnetari 2007; Caro dhe Van Wissen 2007). Dinamika e lëvizshmërisë nënkuptonte se Shqipëria u bë e njohur për emigracionin e saj në nivel ndërkombëtar. Në të njëjtën kohë, pavarësisht se ka qenë një nga proceset më të rëndësishme në Shqipërinë pas komunizmit, lëvizja e brendshme mbetet gjerësisht e padokumentuar dhe sigurisht, e pastudiuar (Vullnetari 2009; Bërzholi 2005; Agorastakis dhe Sidiropoulos 2007).

Migracioni ka qenë një prej tipareve më dinamike të tranzicionit të vendit dhe një prej dukurive më të rëndësishme shoqërore dhe ekonomike (King dhe Vullnetari 2003). Në veçanti migracioni i brendshëm, solli një urbanizim në shkallë të gjerë të disa zonave dhe në një depopullim drastik të disa të tjerave. Pavarësisht ndryshimit rajonal në shkallën e lindshmërisë dhe shkallën relativisht të ulët të vdekshmërisë, ndryshimet më domethënëse të popullsisë në Shqipërinë moderne kanë ardhur si rezultat i ndikimit të kombinuar të migracionit të brendshëm dhe ndërkombëtar (King 2004). Edhe pse lëvizjet e brendshme janë shumëdimensionale, është e dukshme se shumica dërrmuese e flukseve të migracionit të brendshëm është përqendruar drejt Tiranës. Në fakt, janë kryesisht zonat përreth qytetit të Tiranës ato që tërheqin pjesën më të madhe të migrantëve të brendshëm. Përgjithësisht, mund të vihet re se flukset migratore drejt një qyteti të caktuar, qoftë ky Tirana ose Durrësi, devijojnë në destinacionet pranë. Arsyeja që zonat suburbane tërheqin shumicën e të sapoardhurve është thjesht se destinacionit i dëshiruar, zakonisht, është i vështirë për të hyrë, pavarësisht sa tërheqës është. Konkretisht, kostot e banimit dhe disponueshmëria e banesave të përshtatshme shpesh e bëjnë migracionin një sipërmarrje të pamundur. Si rezultat, këta 'migrantë të devijuar' kontribuojnë për formimin e 'vendbanimeve ekstraurbane' me popullsi të dendur (Sjöberg 1992: 13).


Në këtë kapitull, do të përqëndrohem në ndryshimet në periudhën midis vitit 2001 dhe 2011, por kur të jetë e nevojshme, do të merren në konsideratë periudha më të gjata, konkretisht duke filluar që nga censusi i vitit 1989. Migrantët e brendshëm përkufizohen si persona të cilët kanë ndryshuar vendbanimin e zakonshëm në periudhën 2001-2011. Në analizën e këtij kapitulli, do të marrim në konsideratë të gjitha ndryshimet e vendbanimit të zakonshëm në nivel qarku, qyteti ose fshati. Kjo nënkupton se nuk do të konsiderohen lëvizjet në njësitë më të vogla, duke qenë se ato nuk përbëjnë ndryshim në komunitet. Migracioni i brendshëm mund të shprehet në dy përmasa: përmasa hapësinore dhe përmasa kohore. Përmasa hapësinore i referohet migracionit midis dy qarqeve, dy rretheve të të njëjtit qark apo dy qyteteve ose fshatrave. Përmasa kohore përshkruan nëse kjo lëvizje ka ndodhur në një pikë të caktuar në periudhën midis vitit 2001 dhe 2011, si dhe vitin e saktë të lëvizjes së fundit, përpara mbërritjes në vendbanimin aktual. Për analizën e migracionit të brendshëm kryesisht bazohemi në të dhënat e fluksit (lëvizjeve), por ka raste, kur merret në konsideratë dhe ndryshimi absolut i popullsisë. Konkretisht, ndryshimi i popullsisë në periudhën midis vitit 2001 dhe 2011 ose ndryshimi nga viti 1989 në vitin 2011 mund të konsiderohen si pasqyrime të migracionit, duke pasur parasysh se ndryshimet demografike në Shqipëri në lidhje me lindshmërinë dhe vdekshmërinë kanë rëndësi më të vogël për dallimet midis zonave.

Gjeografia e migracionit të brendshëm

Në periudhën 2001-2011, 228.952 individë që jetonin në Shqipëri kanë ndryshuar qarkun e vendbanimit të zakonshëm: këta migrantë përbëjnë 8 përqind të popullsisë banuese në vitin 2011. Lëvizjet në nivel qyteti dhe fshati, në njëjtën periudhë shënojnë një shifër prej 280.863 individësh. Thuajse gjysma e këtyre migrantëve të brendshëm janë rivendosur në qarkun e Tiranës, më saktë në Tiranën suburbane. Kështu, gjatë periudhës 2001-2011, mbi 112.000 individë janë vendosur në qarkun e Tiranës.

Të dhënat e censusit bëjnë të mundur ndërtimin e matricave dhe hartave të migracionit, me qëllim ofrimin e një tabloje më të detajuar të strukturave të migracionit. Harta 2 paraqet ndryshimin e popullsisë për periudhën 2001-2011. Nga 373 komuna dhe bashki në vend, 48 prej tyre kanë humbur më shumë se gjysmën e popullsisë në periudhën 2001-2011. Kjo shifër është e barasvlershme me 13 përqind të tyre. Këto ulje kaq të mëdha të popullsisë mund të ndodhin vetëm për shkak të migracionit të jashtëm në shkallë të madhe, pasi ulja e lindshmërisë mund të kontribuojë në një masë të vogël në këtë zhvillim. Këto 48 komuna/bashki gjenden kryesisht në qendër të pjesës veriore dhe jugore të vendit, por qarqet ose edhe rrethet nuk formojnë njësi homogjene, kur bëhet fjalë për flukset migratore. Në fakt, shumica e komunave shqiptare kanë pësuar ulje të konsiderueshme të popullsisë. Përjashtime të dukshme përbëjnë Tirana dhe zonat suburbane në periferi të saj, rajoni përreth Sarandës, Xarra dhe Ksamili në jug, si edhe disa komuna në qendër të Shqipërisë. Megjithatë, edhe dallimet midis qarqeve janë gjithashtu të dukshme.

Harta 2: Ndryshimi i popullsisë, 2001 – 2011




Shënim: tregohet ndryshimi i popullsisë banuese, i shprehur si përqindje ndaj popullsisë në vitin 2001;


Harta 8 në shtojcë tregon se strukturat e përshkruara këtu nuk janë unike për pjesën më të madhe të dekadës së fundit, por mund të shihen edhe kur merren në konsideratë ndryshimet që prej vitit 1989.

Harta 3: Ndryshimi i popullsisë në disa komuna/bashki rreth Tiranës, 1989 – 2001 dhe 2001 – 2011

1989 - 2001



2001- 2011




Shënim: ndryshimi i popullsisë (si përqindje) në nivel komune; Tirana është në qendër, me komunat përreth që kanë përjetuar rritjen më të madhe.

Duke kombinuar një numër faktorësh dhe mundësish, njerëzit kanë zgjedhur të migrojnë në zonat në afërsi të vendndodhjeve të preferuara urbane. Ndoshta, rritja e zonave suburbane pranë qendrave të rëndësishme urbane ka qenë rezultat i një shkalle të konsiderueshme të atij që Sjöberg-u (1992) e quan migracioni 'jozyrtar'. Për Sjöberg-un, ajo çka ka ndodhur mund të shpjegohet qartë me atë që ai e quan 'migracioni i devijuar' në zonat urbane. Duke ndjekur këtë këndvështrim, ne shqyrtojmë rastin e Tiranës, si qyteti më i preferuar, si në kohën kur shkruante Sjöberg-u, ashtu edhe sot. Si kryeqyteti i vendit, Tirana është karakterizuar gjithnjë nga gama e gjerë e mundësive që ofron. Duke pasur parasysh tërheqjen ndaj Tiranës si qendër e madhe industriale, administrative e kulturore, flukset migratore të orientuara drejt një destinacioni të caktuar në këtë rast, në drejtim të Tiranës, devijohen në destinacionet pranë saj. Në shembullin tonë, devijimi shkon për nga zonat rreth Tiranës, duke qenë se destinacioni i dëshiruar është po aq i vështirë për të hyrë, sa është edhe tërheqës. Nga ana tjetër, këta 'migrantë të brendshëm të devijuar' kanë kontribuar në formimin e 'vendbanimeve ekstraurbane' me popullsi të dendur (Sjöberg 1992:13).

Tirana ka tërhequr historikisht numrin më të madh të migrantëve të brendshëm. Ajo kombinon zhvillimin ekonomik, faktin që është qendra e jetës shoqërore e kulturore, si edhe mundësitë për arsimim më të mirë. Për pasojë, punësimi është përqendruar gjithnjë brenda dhe rreth Tiranës, duke përcaktuar në një masë të madhe orientimin e migracionit të brendshëm. Harta 2 dhe Harta 3 vënë në dukje se komunat rreth Tiranës kanë pasur rritjen më të madhe të popullsisë në periudhën 2001-2011. Migrantët e brendshëm priren të lëvizin sa më pranë që është e mundur destinacionit të dëshiruar dhe në rastin e Tiranës, ata janë vendosur në zonat përreth, si Kamza dhe Paskuqani, komuna që kanë përjetuar rritjen më të madhe të popullsisë në periudhën mes viteve 1989 dhe 2001. Ndërkohë, në dekadën e fundit, në periudhën midis vitit 2001 dhe 2011, popullsia e Farkës, Dajtit dhe Kasharit thuajse është trefishuar.

Nëse marrim në konsideratë qarkun e origjinës së migrantëve të brendshëm, që mbërrijnë në gjashtë komunat rreth Tiranës, shohim se shumica e tyre vijnë nga veriu dhe verilindja e Shqipërisë, më saktësisht nga Kukësi dhe Dibra. 39 përqind e migrantëve të brendshëm që kanë mbërritur në gjashtë komunat përreth kanë ardhur nga Kukësi, ndërsa 34 përqind nga Dibra (Figura 1).


Figura 1. Raporti i migrantëve të brendshëm të ardhur në gjashtë komunat/bashkitë përreth Tiranës sipas qarkut të origjinës, në (%)



Shënim: migrantët e brendshëm drejt gjashtë komunave/bashkive përreth bashkisë së Tiranës: Kashar, Kamëz, Dajt, Paskuqan, Bërshullë, Farkë, si përqindje e numrit të përgjithshëm të migrantëve të brendshëm, të cilët janë larguar nga çdo qark.

Duke marrë në konsideratë shpërndarjen e migrantëve të brendshëm që lëvizin drejt gjashtë komunave përreth Tiranës, është e dukshme se komunat e Kasharit dhe Farkës janë të preferuara nga migrantët e brendshëm, të cilët vijnë nga qarqet jugore, ndërkohë që migrantët e brendshëm nga qarqet veriore përqendrohen kryesisht në komunat e Kamzës dhe Paskuqanit (Figura 2). Për shembull, 44 përqind e migrantëve të brendshëm që lëvizin nga Kukësi, në veri të Shqipërisë, drejt gjashtë komunave përreth Tiranës, vendosen në Kamëz. Në ndryshim me këtë, 61 përqind e migrantëve të brendshëm nga Gjirokastra, në jug të Shqipërisë, vendosen në Kashar. Kemi vënë re se komunat ku priten të vendosen migrantët e brendshëm nga zonat jugore të Shqipërisë gjenden në jug të Tiranës, ndërsa komunat ku vendosen migrantët e brendshëm nga zonat veriore të Shqipërisë gjenden në veri të Tiranës.

Figura 2: Raporti i migrantëve të brendshëm në gjashtë komunat/bashkitë përreth Tiranës sipas qarkut të origjinës, në (%)



Shënim: shpërndarja në gjashtë komunat/bashkitë rreth bashkisë së Tiranës, për çdo qark të origjinës.

E njëjta strukturë mund të konstatohet për periudhën midis vitit 1989 dhe 2001. Gjatë asaj kohe, migrantët e brendshëm nga qarqet veriore (Kukës dhe Dibër) drejt komunave përreth Tiranës kishin tendencë të vendoseshin në komunat e Kamzës dhe Paskuqanit (Migracioni në Shqipëri, INSTAT, 2004). Gjatë dekadës së fundit, numri i migrantëve të brendshëm ka pësuar njëfarë rënieje, por struktura e lëvizjes ka mbetur, në pjesën më të madhe e njëjtë. Përqendrimi i migrantëve në komuna të caktuara është me shumë gjasë, reflektim i rrjeteve të migrantëve, ku migrantët e rinj përdorin kontaktet me migrantët e vendosur, për të lehtësuar lëvizjen. Më i dukshëm është rasti i bashkimit familjar me lidhje të forta ekzistuese me komunitetin e ri.

Komunat si Dajti, Farka dhe Kashari që tërheqin migrantët e brendshëm nga jugu kanë pësuar një rritje në numrin e popullsisë vetëm gjatë dekadës së fundit. Në fakt, një prej tyre - Farka - ende përjetonte humbje të popullsisë në periudhën 1989-2001. Krahësuar me një dekadë më parë, vëmë re një rritje në vlerë absolute të migracionit të brendshëm drejt Tiranës dhe zonave përreth, nga Berati dhe veçanërisht nga Vlora dhe Fieri (shih Migracioni në Shqipëri, INSTAT, 2004). Këto ndryshime në strukturat e migracionit të brendshëm kanë të ngjarë të reflektojnë tërheqjen që ka Tirana, krahasuar me qendra të tjera në Shqipëri apo alternativa për jashtë vendit.


Fluksi i ardhjes së migrantëve nga zona të tjera të Shqipërisë ka sjellë ndryshime thelbësore në gjashtë komunat rreth Tiranës. Tabela 1 tregon sesi përbërja e grupmohave në këto gjashtë komuna ka ndryshuar në periudhën 2001-2011 dhe vë në dukje se këto ndryshime kanë sjellë një ndryshim të rëndësishëm demografik.

Tabela 1. Struktura moshore dhe koeficienti i varësisë në 6 komunat/bashkitë rreth Tiranës, 2001 dhe 2011

Komunat/Bashkitë	2001				2011			
	Grupmosha			Koeficienti i varësisë	Grupmosha			Koeficienti i varësisë
	0-14	15-64	65 +		0-14	15-64	65 +	
Dajt	31,7	62,1	6,2	61,0	23,7	69,1	7,2	44,7
Kamëz	33,7	62,1	4,2	60,9	27,0	66,0	7,1	51,5
Kashar	31,5	62,9	5,5	58,9	21,5	71,1	7,3	40,6
Paskuqan	33,2	62,5	4,3	60,0	27,1	66,2	6,7	51,0
Farkë	32,3	61,9	5,8	61,6	22,7	69,8	7,5	43,3
Bërshullë	34,1	60,6	5,2	64,9	26,3	65,6	8,1	52,4

Në kolonat në të majtë jepet përqindja e tri grupmoshave: ata nën moshën për punë, ata në moshë pune dhe ata mbi moshën 65-vjeçare. Në vitin 2001, rreth një e treta e popullsisë në gjashtë komunat ishte nën moshën e punës dhe rreth 5 përqind mbi këtë moshë. Kjo sjell një koeficient varësie prej rreth 60 përqindësh në gjashtë komunat e marra në konsideratë. Në vitin 2011, popullsia në të gjitha komunat shënon rritje (krahaso me Hartën 3), por struktura moshore ka ndryshuar thelbësisht. Personat nën moshën për punë përbëjnë tashmë më pak se 30 përqind në gjashtë komuna, ndërsa numri i individëve në moshë pune është rritur. Raporti i atyre mbi moshën 65 vjeçe është rritur lehtësisht, duke çuar në një koeficient varësie ndjeshëm më të ulët prej 60 në 50 përqind.

Figura 3: Rritja e popullsisë në periudhën 2001-2011




Shënim: grafiku tregon raportin e popullsisë në vitin 2011 dhe 2001 për komunat/bashkitë e Tiranës, (në herë).

Figura 3 ilustron më tej rritjen e popullsisë në gjashtë komunat në periudhën midis viteve 2001 dhe 2011. Të gjitha kolonat janë më të mëdha se 1, duke treguar rritjen e popullsisë për të gjitha grupet. Sidoqoftë, ka dallime domethënëse në shkallën në të cilën grupmoshat e ndryshme janë rritur në periudhën e trajtuar dhe strukturat e këtyre dallimeve janë të njëjta në të gjitha komunat. Rritja më e vogël e popullsisë mund të shihet te grupmosha më e re, që reflektohet në numrin e saj në ulje, paraqitur në Tabelën 1.

Në ndryshim, rritja e popullsisë te individët në moshë pune është shumë më e lartë, më shumë se dyfishi në Farkë, Dajt dhe Kashar, për dekadën e trajtuar. Edhe Figura 3 ilustron faktin se rritja e popullsisë mes individëve mbi moshën 65-vjeçare ka qenë faktikisht më e lartë se ajo e popullsisë që punon. Duke pasur parasysh rëndësinë relativisht të ulët të këtij grupi në popullsinë e përgjithshme, duket qartë, nga Tabela 1, se koeficienti i varësisë nuk është rritur. Me rritjen e popullsisë mbi moshën 65-vjeç, është e qartë se ulja e koeficientit të varësisë ndodh si pasojë e popullsisë në moshë të re relativisht në rënie - një pasqyrim i nivelit të ulët të lindshmërisë në Shqipëri dhe në Tiranë veçanërisht.

Ashtu si komunat përreth Tiranës që kanë ndryshuar në mënyra të ndryshme, edhe në rang kombëtar migracioni i brendshëm prek zona të ndryshme të Shqipërisë në mënyra jo të ngjashme. Kur përqendrohemi në lëvizjet ndërmjet qarqeve gjatë dekadës së fundit, duket se janë tri entitete ato që janë ndikuar veçanërisht nga ndryshimi i popullsisë në këtë periudhë. Harta 4 tregon raportin midis flukseve hyrëse dhe dalëse me popullsinë e përgjithshme të një qarku të dhënë ('norma e lëvizjes'). Ky është një tregues që shpreh se në ç'skallë preket popullsia nga migracioni. Vlerat e kësaj matjeje janë të larta, në rast se një pjesë e madhe e popullsisë largohet nga qarku, ose nëse një pjesë e madhe e popullsisë ka ardhur gjatë dekadës së fundit ose nëse ndodhin të dyja njëkohësisht në një qark të caktuar. Vlerat më të larta në Shqipëri mund të gjenden në Dibër, me 30,4 përqind, Kukës (29,4 përqind), Gjirokastër (25,3 përqind) dhe Berat (20,7 përqind). Në të gjitha këto raste, nivelet e larta të lëvizjes nxiten nga një migracion i jashtëm domethënës. Nga ana tjetër, norma e lëvizjes në Tiranë (16,6 përqind) dhe Durrës (16,9 përqind) ndikohet në mënyrë mbizotëruese nga migracioni i brendshëm. Edhe pse këto dy aglomerate tërheqin shumë migrantë në shifra absolute, në raport me popullsinë banuese, numri i migrantëve që vijnë në këto qarqe është relativisht i ulët pra, shënohen norma relativisht të ulëta lëvizjeje. Lezha është një rast interesant që shënon një normë lëvizjeje prej 18 përqindësh. Në këtë rast, si migracioni hyrës ashtu edhe ai dalës kontribuojnë në normën e lëvizjes. Në disa vende, ka flukse dalëse të rëndësishme, ndërsa zona të tjera të bregdetit mesdhetar dhe pranë qytetit të Lezhës tërheqin edhe migrantë nga rajone të tjera.

Harta 4: Norma e lëvizjeve sipas qarkut



Shënim: norma e lëvizjeve i referohet shumës së ardhjeve dhe largimeve, shprehur si përqindje e popullsisë në 2011.

Tabela 2: Matrica e migracionit të brendshëm

Qarku 2011	Qarku 2001												
	Berat	Dibër	Durrës	Ebasan	Fier	Gjirokastrë	Korçë	Kukës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë	Gjithsej
Berat		283	154	673	2.123	398	636	450	59	58	418	2.852	8.104
Dibër	569		154	774	1.168	816	280	205	173	102	265	140	4.646
Durrës	3.098	10.064		4.772	2.045	1.066	2.055	3.649	2.160	1.978	2.791	381	34.059
Ebasan	664	534	362		1.418	194	2.320	717	345	1.384	1.141	278	9.357
Fier	3.023	588	339	2.084		2.384	808	1.685	225	443	1.626	2.832	16.037
Gjirokastrë	401	177	69	134	529		220	92	65	85	780	287	2.839
Korçë	609	624	241	2.258	964	194		430	190	427	589	463	6.989
Kukës	102	255	117	95	212	99	102		181	409	326	73	1.971
Lezhë	1.152	1.936	868	2.230	315	161	392	356		4.016	2.241	143	13.810
Shkodër	421	1.046	1.881	416	718	581	475	945	1.356		869	462	9.170
Tiranë	9.811	21.279	6.048	10.120	13.968	7.527	10.985	13.965	5.230	8.159		5.088	112.180
Vlorë	1.405	248	248	825	2.200	2.002	521	623	272	552	894		9.790
Gjithsej	21.255	37.034	10.481	24.381	25.660	15.422	18.794	23.117	10.256	17.613	11.940	12.999	228.952


Shënim: të dhënat tregojnë shifrat e individëve që kanë ndryshuar vendbanimin e zakonshëm në periudhën 2001-2011; për shembull, në periudhën midis vitit 2001-2011, 283 individë kanë lëvizur nga qarku i Dibrës në qarkun e Beratit, ndërkohë që 10.064 individë kanë lëvizur nga qarku i Dibrës në atë të Durrësit (pjesa e tabelës lart në të majtë).

Duke marrë në konsideratë drejtimin e flukseve të migracionit të brendshëm, mund të dallohen lloje të ndryshme fluksesh, sipas rivendosjes së tyre rajonale dhe llojit të vendbanimit. Matrica e migracionit të brendshëm (Tabela 2) paraqet lëvizjet e brendshme sipas qarkut të vendbanimit në vitin 2001 dhe qarkut të vendbanimit në 2011. Ajo dëshmon një zhvendosje të qartë të popullsisë nga veriu (sidomos verilindja), pjesa jug-qendrore dhe juglindore drejt qendrës. Zonat kryesore nga vijnë migrantët e brendshëm janë qarqet e Dibrës, Kukësit dhe Gjirokastrës, ku më shumë se 21 përqind të popullsisë së tyre është larguar gjatë periudhës 2001-2011. Dibra dhe Kukësi janë gjeografikisht zona të rrethuara nga male dhe shënojnë disa prej niveleve më të larta të papunësisë dhe shkallës së varfërisë, si edhe mundësi të kufizuara ekonomike (Lundstrom dhe Ronnas 2006: 24-25). Në dallim, migracioni i brendshëm nga Gjirokastra është orientuar drejt qarqeve qendrore dhe bregdetare. Megjithatë, migracioni i brendshëm ulet nga emigrimi sidomos në Greqi.

Në pjesën qendrore të Shqipërisë, ku mbizotërojnë flukset hyrëse, shumica e migrantëve të brendshëm përqëndrohen në Tiranë dhe Durrës. Më pak domethënëse kanë qenë flukset migratore përgjatë zonave bregdetare. Në krahasim me qarqet e tjera, Tirana shënoi rritjen më të lartë, me 112.180 rezidentë të rinj që vinin nga qarqe të tjera të Shqipërisë, e ndjekur nga Durrësi me 34.059 rezidentë të rinj. E thënë ndryshe, në vitin 2011, 49 përqind e migrantëve të brendshëm u vendosën në Tiranë, kurse 15 përqind në Durrës.


Strukturat gjeografike të lëvizjes midis qarqeve përshkruhen në Hartën 5. Hartat tregojnë strukturat e flukseve dalëse për çdo qark. Për shembull, mes migrantëve të brendshëm që janë larguar nga Berati gjatë dekadës së fundit, rreth 40-50 përqind e tyre kanë migruar drejt qarkut të Tiranës, 10-20 përqind drejt qarqeve të Durrësit dhe Fierit, ndërkohë që qarqe të tjera regjistrojnë 0,5-10 përqind të migrantëve të brendshëm nga Berati. Hartat ilustron faktin se fluksi më domethënës i migracionit të brendshëm është në Tiranë dhe në një shkallë më të vogël në Durrës. Në rastet e Dibrës, Durrësit, Fierit, Korçës, Kukësit dhe Lezhës, më shumë se gjysma e migrantëve që largohen nga këto qarqe migrojnë drejt Tiranës.

Harta 5: Lëvizjet e brendshme sipas qarkut të destinacionit



Shënim: këto harta ilustrojnë qarkun drejt cilit lëvizin migrantët e brendshëm (si përqindje e të gjithë migrantëve), 2001-2011; zonat me ngjyrë gri i referohen qarkut të origjinës.

Harta 6: Lëvizjet e brendshme sipas qarkut të origjinës



Shënim: këto harta ilustrjnë qarqet nga të cilat kanë ardhur migrantët e brendshëm (si përqindje e të gjithë migrantëve) nga viti 2001 deri në 2011; pjesët me ngjyrë gri i referohen qarkut të destinacionit.


Një këndvështrim i kundërt jepet në Hartën 6, e cila tregon se nga vijnë migrantët e brendshëm për secilin qark. Ajo tregon përqindjen e migrantëve të brendshëm në një qark të dhënë, të cilët vijnë nga qarqet e tjera. Për shembull, ndërkohë që Harta 5 tregon se Tirana është destinacioni i preferuar për migrantët e brendshëm, përbërja e origjinës së këtyre migrantëve të brendshëm jepet në Hartën 6. Nga të gjithë migrantët e brendshëm që erdhën në Tiranë në periudhën 2001-2011, 19 përqind vinin nga Dibra, 12 përqind nga Kukësi dhe Fieri dhe 5-10 përqind nga Shkodra, Berati, Durrësi, Elbasani, Gjirokastra, Korça, kurse më pak se 5 përqind vinin nga Lezha dhe Vlora. Në dallim nga Tirana, qarqet origjinë për Durrësin janë më pak të larmishme: pjesa më e madhe e migrantëve të brendshëm që mbërritën në Durrës në periudhën midis vitit 2001 dhe 2011 erdhën nga Dibra (30 përqind), Elbasani (14 përqind) dhe Kukësi (11 përqind). Qarku i tretë i rëndësishëm i destinacionit në Shqipëri është Fieri, i ndjekur nga Lezha. Në jug të vendit, Fieri duket se është qark tërheqës për migrantët e brendshëm që vijnë nga Berati (19 përqind), Vlora (18 përqind), Gjirokastra (15 përqind) dhe Elbasani (13 përqind). Nga ana tjetër, Lezha është qarku i preferuar në veri të vendit, duke tërhequr migrantët e brendshëm nga Shkodra (29 përqind), Dibra (14 përqind), Elbasani (16 përqind) dhe Tirana (16 përqind).

Duke parë vetëm lëvizjet e brendshme në periudhën midis janarit 2010 dhe tetorit 2011, gjeografia e migracionit të brendshëm ka shumë ngjashmëri me strukturat e përshkruara në paragrafët e mësipërm mbi lëvizjet gjatë periudhës 2001-2011 (Tabela 5 në shtojcë). Tirana është qarku mbizotërues sa i përket numrit të migrantëve hyrës, me 58 përqind të të gjithë migrantëve të brendshëm që i drejtohen Tiranës. Kjo është 9 pikë përqindje më e lartë në krahasim me periudhën nga viti 2001 në vitin 2011. Një tjetër qark që ka përjetuar rritje të numrit të migrantëve të brendshëm së fundmi është Vlora, me 6 përqind të të gjithë migrantëve të brendshëm. Ky numër është 2 pikë përqindje më i lartë sesa gjatë periudhës 2001-2011. Një gjë e tillë mund të ketë lidhje me numrin relativisht të lartë të migrantëve të kthyer në këtë qark, kryesisht midis vitit 2008 dhe 2011.

Dinamikat e migracionit të brendshëm

Të dhënat e censurit mundësojnë analizën e dinamikave të lëvizjeve të brendshme, në kuptimin që mund të shqyrtojmë nëse migrantët e brendshëm kanë prirje të lëvizin drejtpërdrejt nga origjina në destinacion apo nëse kryejnë lëvizje të shumëfishta. Analiza në këtë pjesë bazohet në lëvizjet në nivel rrethi të qarqeve të ndryshme ose të të njëjtit qark, siç ilustrohet në Figurën 4. Figura 4 tregon katër rastet e analizuara. Në rastin e parë, tregohet migrimi i drejtpërdrejtë nga njëri qark në tjetrin. Në rastin e dytë dhe të tretë tregohen shembuj kur migrantët e brendshëm janë zhvendosur të paktën dy herë për të arritur në qarkun e destinacionit. Rasti i katërt tregon lëvizje të brendshme në të cilat individët kanë ndryshuar rrethin brenda të njëjtit qark.


Figura 4: Dinamikat e migracionit të brendshëm



Shënim: katër rastet e migracionit të brendshëm. Dy nuancat e blusë dhe të verdhës tregojnë dy rrethe të ndryshme në të njëjtin qark.

Duke pasur parasysh lëvizjet ndërmjet qarqeve të ndryshme, vihet re se lëvizjet e drejtpërdrejta (rasti i parë në Figurën 4) janë shumë herë më të zakonshme, sesa rastet e tjera. Kjo nënkupton se, normalisht, njerëzit që ndryshojnë qarkun lëvizin drejtpërdrejt. Qarku i Tiranës ka përqindjen më të lartë të migrantëve të brendshëm që kanë lëvizur drejtpërdrejt (97 përqind); qarku i Dibrës ka shifrën më të ulët, me 91 përqind. Në fakt, lëvizjet e brendshme drejt Dibrës karakterizohen nga një normë më e lartë individësh, të cilët e kanë ndryshuar rrethin të paktën dy herë, krahasuar me lëvizjet e brendshme drejt qarqeve të tjera (Figura 5).


Figura 5: Migrantët e brendshëm të cilët lëvizin direkt në qarkun e tyre të fundit të vendbanimit, në (%)



Shënim: përqindja e migrantëve të brendshëm që kanë lëvizur drejtpërdrejt në qarkun e fundit të banimit (krahasuar me ata që e kanë ndryshuar rrethin pas largimit nga qarku i vendqëndrimit në vitin 2001 dhe vendosjes në qarkun aktual të qëndrimit); shih Figurën 4 për një shpjegim të llojeve të ndryshme të lëvizjeve.

Edhe pse shumica e migrantëve të brendshëm kanë lëvizur drejtpërdrejt (Figura 5), ka një ndryshim të dukshëm në shkallën në të cilën migrantët e brendshëm kanë lëvizur shumë herë (Figura 6). Këta përbëjnë rastet e dyta e të treta të ilustruara në Figurën 4, duke vënë në dukje ata migrantë të cilët ka të ngjarë që nuk janë në gjendje të realizojnë projektin e tyre të migracionit herën e parë që lëvizin. Lëvizjet përfshijnë ato nga një rreth në tjetrin brenda të njëjtit qark dhe më pas në një qark tjetër, ose nga një rreth në tjetrin në qarqe të ndryshme dhe më tej në një rreth tjetër të të njëjtit qark. Për shembull, migrantët e brendshëm mund të mos gjejnë strehim të përshtatshëm pranë vendit të ri të punës ose, si pasojë e lëvizjes së parë, linden mundësi të reja të cilat çojnë në një lëvizje tjetër. Në secilin prej qarqeve, më pak se 10 përqind e migrantëve të brendshëm kanë kryer lëvizje të shumëfishta. Nga njëra anë, kjo thekson rëndësinë e lëvizjeve të drejtpërdrejta në periudhën afatmesme që mbulohet nga koha midis dy censuseve. Nga ana tjetër, përqindjet në Figurën 6 dëshmojnë se lëvizjet e shumëfishta brenda harkut të një dekade nuk janë aspak një përvojë e panjohur në Shqipëri.

Figura 6: Migrantët e brendshëm të cilët ndryshojnë rrethin të paktën dy herë përpara mbërritjes në vendbanimin e fundit, në (%)



Shënim: kanë ndryshuar rrethin të paktën dy herë ndërmjet 2001 dhe 2011.

Rasti i katërt përshkruan migrantët e brendshëm, të cilët e kanë ndryshuar rrethin, të paktën njëherë gjatë periudhës 2001-2011, por nuk kanë ndryshuar qarkun e vendbanimit të tyre të zakonshëm. Ka një numër të konsiderueshëm të migrantëve të brendshëm, të cilët kanë ndryshuar vetëm rrethin e vendbanimit të zakonshëm, me variacion domethënës ndërmjet qarqeve. Më shumë se gjysma e migrantëve të brendshëm në qarkun e Lezhës kanë ndryshuar rrethin të paktën njëherë, ndjekur nga qarku i Beratit, Fierit dhe Durrësit, me më shumë se 31 përqind. Këto struktura migracioni vënë në dukje rëndësinë e urbanizimit, edhe përtej tërheqjes së përgjithshme për t'u zhvendosur drejt Tiranës (shih Ravenstein 1885 dhe ligjet e tij të migracionit).

Figura 7: Migrantët e brendshëm, që ndryshojnë qarkun kundrejt atyre që lëvizin brenda të njëjtit qark, në (%)





Figura 7 thekson dallimin midis migrantëve të brendshëm që kanë ndryshuar qarkun dhe atyre që kanë lëvizur brenda të njëjtit qark. Rëndësia e këtyre dy strukturave të migracionit ndryshon në mënyrë domethënëse midis qarqeve. Për shembull, 96 përqind e lëvizjeve drejt Tiranës vijnë nga një qark tjetër, ndërkohë që vetëm 37 përqind e lëvizjeve drejt Kukësit përfshijnë ndryshimin e qarkut. Nëse flasim në përgjithësi, sidoqoftë, lëvizjet ndërmjet qarqeve janë më të

zakonshme, sesa lëvizjet brenda së njëjtit qark. Në gjysmën e qarqeve, shumica e migrantëve të brendshëm kanë ardhur nga qarqe të ndryshme: Tirana (96 përqind), Durrësi (94 përqind), Vlora (80 përqind), Fieri (59 përqind), Lezha (56 përqind) dhe Shkodra (53 përqind). Kjo reflekton strukturat e diskutuara në kontekstin e Hartës 6: Tirana dhe zonat bregdetare tërheqin migrantë të brendshëm nga qarqe të tjera, kurse në zonat e tjera mbizotërojnë lëvizjet brenda qarkut.

Karakteristikat e migrantëve të brendshëm

Pas paraqitjes së strukturave kryesore gjeografike të migracionit të brendshëm në Shqipëri, në paragrafët vijues do të vihen në dukje disa tipare demografike dhe arsimore të migrantëve të brendshëm, për të ilustruar, ndikimin e migracionit në pjesë të ndryshme të shoqërisë, më shumë se në disa të tjera. Gjatë dekadës së fundit, rreth 10 përqind e banorëve u zhvendosën brenda vendit, duke ndryshuar qytetin ose fshatin e vendbanimit të zakonshëm. Të dhënat e censurit kanë treguar se migrantët e brendshëm janë përgjithësisht të rinj. Më shumë se 50 përqind e migrantëve që kanë ndryshuar qytetin ose fshatin e vendbanimit ishin të grupmoshës 15-34 vjeç, ndërkohë që kulmi shënohet në moshën 20-24 vjeç. Gratë janë ato që kanë më shumë gjasa të migrojnë brenda vendit sesa burrat, duke përbërë 59 përqind të migrantëve të brendshëm – raporti gjinor është 69 burra për 100 gra (Figura 8).


Figura 8: Migrantët e brendshëm sipas grupmoshës dhe gjinisë, 2001-2011



Shënim: numri i migrantëve të brendshëm të cilët kanë ndryshuar qarkun e vendbanimit të zakonshëm në periudhën 2001-2011.

Figura 9 paraqet situatën për dekadën pararendëse duke vënë në dukje se, fakti që gratë kanë më shumë të ngjarë të lëvizin brenda vendit, nuk është asgjë e re në Shqipëri. Në fakt, prirja më e lartë e grave për të migruar ishte njohur nga Ravenstein (1885) në ligjet e tij të migracionit. Duke krahasuar Figurën 8 dhe Figurën 9, vëmë re se shpërndarja moshore e migrantëve të brendshëm në Shqipëri ka ndryshuar, duke u përqëndruar më shumë te të rinjtë adult, gjatë dekadës së fundit. Në dallim nga dekada e mëparshme (1989-2001), individët në moshën 35 vjeç e sipër nuk kanë aspak gjasa të lëvizin njësoj si bashkatdhetarët e tyre të rinj. Gjatë dekadës së mëparshme, u pa një rënie graduale në prirjen për të lëvizur, pas arritjes së kulmit rreth moshës 30-vjeç.

Figura 9: Migrantët e brendshëm sipas grupmoshës dhe gjinisë, 1989-2001




Shënim: numri i migrantëve të brendshëm, të cilët kanë ndryshuar qarkun e vendbanimit të zakonshëm në periudhën midis vitit 1989 dhe 2001

Mbizotërimi numerik i grave mes migrantëve të brendshëm është veçanërisht i dukshëm te grupmoshat më të reja. Raporti i lartë i grave mes migrantëve të brendshëm në moshë të re pasqyron rëndësinë e arsyeve familjare për migracionin e brendshëm, përfshi gratë që migrojnë për qëllime martesë dhe krijimit të familjes (patrilokaliteti). Në të vërtetë, analizat e mëparshme tregojnë se gratë në zonat rurale nxiten të lëvizin, pasi nuk kanë të drejta mbi trashëgiminë familjare (fermat) ose ka më shumë mundësi të gjejnë punë në sektorin terciar në zonat urbane. Me këtë lidhet edhe konstatimi se në arsimin e lartë ka më shumë gra se burra. Ato, gjithashtu, lëvizin më shpesh pas martesës. Në dallim nga sa më lart, arsyet e tjera që ndikojnë në migrimin e brendshëm, si punësimi dhe studimet, kanë një ndikim pothuajse të njëjtë si për meshkujt edhe për femrat, të paktën për moshat e reja. Burrat në moshën 35-vjeç e sipër kanë pak më shumë gjasa të migrojnë brenda vendit, sesa gratë. Numri i migrantëve të brendshëm pëson një rënie të konsiderueshme pas moshës 55-vjeçare për të dyja gjinitë.

Migracioni i brendshëm karakterizohet nga zhvendosja e familjeve. Figura 10 tregon se më shumë se gjysma e migrantëve të brendshëm ishin të martuar. Më shumë se 37 përqind ishin beqarë dhe më pak se 4 përqind të divorcuar dhe të ve. Ashtu siç tregon Figura 12 më poshtë, arsyet familjare janë të rëndësishme në të gjitha grupmoshat, duke nxjerrë në pah më tej se migracioni i brendshëm dominohet më shumë nga familjet sesa nga individët që migrojnë.


Figura 10: Migrantët e brendshëm sipas statusit civil



Shënim: ndryshimi i vendbanimit të zakonshëm midis vitit 2001 dhe 2011.

Rëndësia e arsyeve familjare theksohet më tej në Figurën 11: kjo është arsyeja më e rëndësishme që kanë dhënë si burrat, edhe gratë. Mbizotërimi i arsyeve familjare është më i spikatur tek gratë sesa tek burrat. Nga ana tjetër, janë më shumë burrat ata që lëvizin për arsye punësimi, sesa gratë. Të dyja ndryshimet përputhen me mbizotërimin e qëndrueshëm të formave familjare patriarkale, ku burri është ai që siguron jetesën dhe familja lëviz bashkë me siguruesin e jetesës, në rastet kur është e nevojshme. Sa i përket studimit si arsye të migracionit të brendshëm, gratë janë më të prirura të lëvizin sesa burrat. Kjo arsye është më e përhapur te të rinjtë adultë të grupmoshës 15-24 vjeç, ndërsa arsyet për punësim janë më të dukshme mes grupmoshës 30-64 vjeç (Figura 12). Rëndësia relative e arsyeve të ndryshme është gjerësisht e njëjtë për të dyja gjinitë, megjithatë duhet theksuar se arsyet familjare zënë peshën më të madhe sesa arsyet e studimit dhe punësimit.


Figura 11: Arsyeja kryesore e migracionit të brendshëm sipas gjinisë, në (%)



Shënim: ndryshim i vendbanimit të zakonshëm në periudhën 2001-2011.

Figura 12 ilustron se si arsyet për të migruar brenda Shqipërisë ndryshojnë sipas grupmoshave. Ajo tregon përqindjen e të gjithë migrantëve të brendshëm të një grupmoshe, sipas arsyes kryesore të migracionit të brendshëm. Figura 12 ilustron rolet e ndryshuara gjatë jetës së një personi. Migrantët më të rinj janë tërësisht të lidhur me familjet e tyre e si rrjedhim lëvizin bashkë me to. Gjithnjë e më tepër del në pah rëndësia e arsyes për studim, e cila zë peshën më të lartë relative në vitet e adoleshencës së vonë. Ndërsa sa i përket arsyes për punësim, ajo fillon të bëhet e dukshme në grupmoshën 15-19 vjeç.


Figura 12: Migrantët e brendshëm sipas grupmoshës dhe arsyes kryesore të migrimit, në (%)



Shënim: ndryshimi i vendbanimit të zakonshëm në periudhën 2001-2011.

Për të gjithë individët që lëvizin brenda Shqipërisë, ka dallime të rëndësishme sa i përket nivelit arsimor. U konstatua se grupi më i madh i migrantëve të brendshëm kanë arsim 7/8/9 vjeçar, ku gratë janë ato që dominojnë. Në dallim nga sa më sipër, migrantët e brendshëm meshkujt me arsim të mesëm janë thujtse të njëjtë në numër me migrantët e brendshëm me arsim 7/8/9 vjeçar. Kjo shpërndarje e nivelit arsimor përkon gjerësisht me situatën e përgjithshme ekzistuese në Shqipëri. Nënkuptohe se individët pavarsisht nivelit të tyre arsimor kanë pak a shumë prirje të njëjta për të lëvizur.

Figura 13: Migrantët e brendshëm sipas nivelit arsimor dhe gjinisë, në (%)




Shënim: ndryshimet e vendbanimit të zakonshëm në periudhën 2001-2011.

Modeli individual

Në seksionin e mësipërm vumë re se disa grupe të shoqërisë janë më të prirura të lëvizin në një qark tjetër, sesa grupe të tjera. Krahasimet midis dy variablave ofrojnë një tablo të pasur, por rëndësia e secilit faktor në raport me të tjerët mbetet e paprovuar. Është përdorur një analizë e thjeshtë regresioni, për të përshkruar sesi karakteristikë të ndryshme në nivel individual ndikojnë në prirjen e individëve për të lëvizur. Regresioni logjistik me variabla të shumëfishta është përdorur për të parashikuar nëse individë ka lëvizur midis vitit 2001 dhe 2011. Rezultatet e paraqitura në Figurën 14 mund të kuptohen si përshkrim i faktorëve që ndikojnë në prirjen e individëve për të lëvizur, ose anasjelltas për të qëndruar në vendin ku jetojnë.

Variabli i varur tregon nëse vendbanimi i zakonshëm në vitin 2011 gjendet në një qark apo rreth të ndryshëm nga ai i vitit 2001. E thënë ndryshe, kapen të gjitha llojet e migracionit të brendshëm, me përjashtim të lëvizjeve lokale që ndodhin brenda të njëjtit komunitet. Si variabla shpjegues u konsiderua mosha, gjinia, statusi civil dhe niveli arsimor i individit. Për statusin civil, kategoritë i/e ndarë dhe i/e divorcuar u kombinuan, për shkak të numrit relativisht të vogël të rasteve dhe për më tepër sepse nuk ka arsye teorike për të pritur ndryshime midis këtyre dy grupeve. Niveli arsimor matet me vitet shkollore të përfunduara. Janë paraqitur tri modele, një për popullsinë gjithsej, një për popullsinë urbane dhe një për atë rurale.

Figura 14: Modeli individual, 2001-2011




Shënim: janë dhënë raportet e probabilitetit, vlera më të madhe se 1 do të thotë - prirje më e madhe për të lëvizur ndërsa vlera më të vogël se 1 - prirje më të vogël për të lëvizur; variabli i varur: ka ndryshuar qark ose rreth në periudhën 2001-2011 popullsia banuese; kategoritë e referimit: për gjininë - femër, për statusin civil - beqar.

Prirjet kryesore në Figurën 14 janë të njëjta për të tri modelet. E thënë ndryshe, nuk duket se ka dallime të dukshme në strukturat e migracionit të brendshëm midis atyre që largohen nga zonat rurale dhe urbane. Në të gjitha rastet, ka më shumë të ngjarë që individët në moshë më të madhe të migrojnë, ndërsa burrat janë përgjithësisht më pak të prirur të migrojnë brenda vendit, sesa gratë. Krahasuar me beqarët (të pamartuar asnjëherë), personat e martuar kanë më shumë të ngjarë të migrojnë brenda vendit. Për individët e ndarë ose të divorcuar, gjasa për të migruar është disi më e lartë, ndërkohë që individët e ve kanë më pak gjasë të migrojnë. Sa i përket arsimit, konstatohet se personat me më shumë vite shkollimi kanë më pak të ngjarë të migrojnë brenda vendit, sesa ata me nivel arsimor të ulët.

Ndikimi i moshës është relativisht i vogël: duhet një ndryshim në moshë prej rreth 20 vjetësh për të dyfishuar shanset për të migruar brenda vendit. Burrat kanë të ngjarë të lëvizin 0.94 herë më shumë se gratë, duke treguar se hendeku gjinor është relativisht i vogël. Sa i përket statusit civil, mund të dallohet një ndryshim i madh. Personat e martuar në zonat urbane kanë dy herë më shumë të ngjarë të lëvizin, sesa ata që nuk janë martuar asnjëherë, kurse në zonat rurale tri herë më shumë, sesa ata që nuk janë martuar asnjëherë. Kjo mbështet rëndësinë e migracionit familjar të theksuar më sipër, sidomos faktin se gratë lëvizin në kontekstin e martesës, prirje e cila rritet më shumë pas martesës (Lerch 2013). Efekti statistikor i arsimit sugjeron se individët që kanë 11 vite shtesë shkollimi kanë prirje të lëvizin sa gjysma e atyre që nuk e kanë këtë arsim. E thënë ndryshe, një vit i vetëm arsimor shtesë nuk duket se ka ndikim të lartë në vendimin për të migruar brenda vendit.

Për të bërë një krahasim, Figura 15 tregon modelet e barasvlershme për periudhën 1989-2001. Në dekadën e mëparshme, kishte më shumë dallime të dukshme midis zonave urbane dhe rurale, jo vetëm sa i përket statusit civil, por edhe gjinisë dhe nivelit arsimor. Kjo sugjeron se natyra e migracionit ka ndryshuar në mënyrë thelbësore. Është e dukshme sidomos ngjashmëria midis llojit të migracioni urban e rural për periudhën 2001- 2011.

Figura 15: Modeli individual, 1989-2001



Shënim: janë dhënë raportet e probabilitetit, vlera më të madhe se 1 do të thotë - prirje më e madhe për të lëvizur ndërsa vlera më të vogël se 1 - prirje më të vogël për të lëvizur; variabli i varur: ka ndryshuar qark ose rreth në periudhën 2001-2011 popullsia banuese; kategoritë e referimit: për gjininë - femër, për statusin civil - beqar.

3. MIGRACIONI NDËRKOMBËTAR

Emigracioni

Emigracioni është një nga arsyet kryesore të uljes së numrit të popullsisë në Shqipëri në periudhën midis 2001 dhe 2011. Duke pasur parasysh se shqiptarët vendbanues nuk regjistrohen sistematikisht kur largohen nga vendi dhe, duke qenë se ka pak stimuj që ata të regjistrojnë largimin te autoritetet vendore, nuk ka matje të besueshme të numrit të individëve që janë larguar nga Shqipëria. Sidoqoftë, është e mundur që të përdoren metoda të tërthorta për kryerjen e një vlerësimi të numrit të individëve që kanë emigruar në periudhën 2001-2011. Paragrafët në vijim përshkruajnë hapat e ndërmarra për të llogaritur numrin dhe gjininë e individëve të cilët kanë ndryshuar vendbanimin e tyre të zakonshëm nga Shqipëria në një vend jashtë saj në periudhën midis 2001 dhe 2011: numri i emigrantëve sipas gjinisë.

Si hap i parë, është marrë si bazë popullsia në 1 Janar 2001. Janë konsideruar moshat, ashtu edhe gjinia e individëve. Si hap i dytë, është marrë informacion mbi lindjet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) për çdo vit, duke marrë në konsideratë numrin e meshkujve dhe femrave të lindura. Si hap i tretë, numri i vdekjeve sipas moshës dhe gjinisë llogaritet duke marrë parasysh normat specifike të vdekshmërisë, bazuar në projeksionet e popullsisë të censusit të vitit 2001 (Projeksionet e popullsisë për Shqipërinë, 2004). Për secilën grupmoshë, numri i vdekjeve u zbrit nga popullsia e vitit 2001. Për popullsinë në moshën zero vjeç, është marrë në konsideratë numri i lindjeve gjatë vitit paraardhës. Kjo procedurë u përsërit, më pas, për çdo vit, deri në 1 Janar 2012, siç ilustron Figura 16. Figura tregon procedurat për meshkujt, ndërkohë që e njëjta procedurë u ndoq edhe për femrat. Rezultati është një llogaritje e shpërndarjes moshore të popullsisë për çdo vit të periudhës 2001-2012.

Figura 16: Llogaritja indirekte: Struktura moshore e meshkujve

	Popullsia e meshkujve			
	2001		2002	
Mosha	Popullsia	Vdekjet	Popullsia	Vdekjet
Gjithsej	1.527.498	11.014	1.544.935	10.773
0	28.178	531	28.451	419
1	27.621	60	27.647	57
2	26.974	47	27.561	46
3	28.628	40	26.927	36
4	30.285	36	28.588	33
5	32.261	25	30.249	22
6	30.185	21	32.236	22
7	29.516	19	30.164	19
8	31.587	18	29.497	16
9	34.006	21	31.569	19
10	34.321	13	33.985	12

Lindjet e meshkujve në 2001

Vdekjet nën 1 vjeç

Procedura e parashtruar bën llogaritje të një popullsie të mbyllur, që nuk merr parasysh migracionin. Për të llogaritur numrin e emigrantëve, është e nevojshme që, si hap i mëtejshëm, të krahasohet popullsia e mbyllur, siç është llogaritur më lart, me popullsinë e censusit. Së pari, popullsia e llogaritur deri më 1 Janar 2012 (d.m.th., popullsia e mbyllur) u ekstrapolua më 1 Tetor 2011, për të qenë në përputhje me popullsinë në të njëjtën datë (1 Tetor 2011). Kjo u bë duke i shtuar popullsisë së 1 Janarit 2012 numrin e personave që kishin vdekur në tremujorin e katërt (tetor-dhjetor) të vitit 2011. Për më tepër, për individët me moshë zero, u hoqën lindjet e tremujorit të katërt (tetor-dhjetor) të vitit 2011. U kryen korrigjime të njëjta për të gjitha moshat, duke mbajtur parasysh ndryshimin e popullsisë në tremujorin e fundit.

Figura 17: Llogaritje indirekte: Kalimi në datën e censurit

Popullsia e meshkujve					
Mosha	Popullsia e projektuar 1/01/2012	Vdekjet Tetor-Dhjetor 2011	Popullsia + Vdekjet	Lindjet Tetor-Dhjetor 2011	Popullsia në 1/10/2011
0	18.672	35	18.707	4.831	18.514
1	18.543	8	18.551		18.523
2	18.438	2	18.440		18.468
3	18.551	1	18.552		18.533
4	18.476	1	18.477		18.663
5	19.218	2	19.220		19.594
6	20.714	1	20.715		20.946
7	21.635	3	21.638		22.173
8	23.776	0	23.776		23.385
9	22.207	3	22.210		23.609
10	27.806	1	27.807		27.706

Lindjet
tetor-dhjetor
2011

Shënim: numri i vdekjeve për çdo moshë të tremujorit të fundit u shtua për çdo moshë (kolona 4 – Popullsia + Vdekjet); më pas, me qëllim që të korrigjonim moshën, për moshën zero vjeç u hoq numri i lindjeve të tremujorit të fundit (treguar në kolonën 5), ndërkohë që u shtua një e katërta e vlerës së moshës së pasardhëse (kolona 4); për moshat e tjera, u hoq një e katërta e vlerës së saj, ndërkohë që u shtua një e katërta e vlerës së moshës pasardhëse (treguar në kolonën e fundit).

Ashtu si më parë, e njëjta procedurë u zbatua edhe për femrat dhe më tej, popullsia gjithsej u përllogarit si shuma e të dyjave. Pasi korrigjuam projeksionet për të qenë në përputhje me datën e censurit (1 Tetor) dhe jo me 1 Janarin, u bë e mundur të llogaritej diferenca midis popullsisë së mbyllur të projektuar për datën 1 Tetor 2011 dhe popullsisë së numëruar gjatë censurit, pasi kishim bërë rregullimet e mundshme duke marrë parasysh rezultatet e Anketës pas Censurit (PES). Diferenca midis këtyre dy shifrave treguar në Figurën 18 është migracioni neto (treguar në të majtë në Figurën 19).

Figura 18: Krahësimi i popullsisë së projektuar dhe asaj të censurit

Popullsia e Census me PES 1/10/2011			Grupmosha	Popullsia e mbyllur e projektuar 1/10/2011		
Gjithsej	Meshkuj	Female		Gjithsej	Meshkuj	Female
2.905.339	1.455.577	1.449.762		3.276.725	1.634.224	1.642.501
169.544	88.887	80.657	0 - 4	175.574	92.701	82.873
188.405	99.124	89.281	5 - 9	207.983	109.707	98.276
241.939	124.827	117.112	10 - 14	266.593	138.356	128.237
278.662	140.773	137.889	15 - 19	300.376	153.846	146.530
252.792	132.878	119.914	20 - 24	324.629	165.389	159.240
199.169	102.460	96.709	25 - 29	298.209	146.489	151.720
170.178	82.430	87.748	30 - 34	233.590	111.614	121.976
173.842	81.872	91.970	35 - 39	211.404	100.348	111.056
193.509	92.301	101.208	40 - 44	213.645	102.710	110.935

Popullsia në census përfshin edhe emigrantët e kthyer, të cilët janë kthyer në Shqipëri në periudhën 2001-2011. Ashtu siç ndodh përgjithësisht, është bërë një disagregim sipas moshës dhe gjinisë (Figura 19). Të kthyer u konsideruan ata persona, të cilët ishin vendbanues të zakonshëm jashtë vendit në censusin e fundit dhe u kthyen pas censusit (1 prill 2001). Për vitin 2001, procedura që u ndoq ishte si vijon: numrit të të kthyerve në vitin 2001 (të kthyer nga 1 prilli në 31 dhjetor 2001) iu shtua një e treta e vlerës së tyre, me qëllim që të kishim numrin e përgjithshëm të të kthyerve për atë vit dhe jo vetëm për 9 muaj. Nga migracioni neto u zbrit numri i emigrantëve të kthyer në të djathtë të Figurës 19, për të nxjerrë numrin e emigrantëve në periudhën midis 1 Janarit 2001 dhe 1 Tetorit 2011.

Figura 19: Llogaritje indirekte: Migracioni neto dhe numri i migrantëve të kthyer, sipas grupmoshës dhe gjinisë

Migracioni neto			Grupmosha	Të kthyerit		
Gjithsej	Meshkuj	Femra		Gjithsej	Meshkuj	Femra
-371.386	-178.647	-192.739		110.215	64.622	45.593
-6.030	-3.814	-2.216	0 - 4	3.772	1.918	1.854
-19.578	-10.583	-8.995	5 - 9	6.336	3.240	3.096
-24.654	-13.529	-11.125	10 - 14	8.629	4.394	4.235
-21.714	-13.073	-8.641	15 - 19	9.362	4.551	4.811
-71.837	-32.511	-39.326	20 - 24	12.233	6.170	6.063
-99.040	-44.029	-55.011	25 - 29	10.468	6.697	3.771
-63.412	-29.184	-34.228	30 - 34	13.374	8.945	4.429
-37.562	-18.476	-19.086	35 - 39	11.607	8.211	3.396
-20.136	-10.409	-9.727	40 - 44	8.705	6.158	2.547

Në Figurën 20 përdoren vlera negative për të treguar emigracionin për një qelizë të caktuar (grupmoshe dhe gjinie), kurse numrat pozitivë tregojnë imigracionin.

Figura 20: Vlerësim i tërthortë: Mosha dhe gjinia e numrit të emigrantëve


Emigrantët 2001-2011			
Grupmosha	Emigrantët		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Total	-481.601	-243.269	-238.332
0 - 4	-9.802	-5.732	-4.070
5 - 9	-25.914	-13.823	-12.091
10 - 14	-33.283	-17.923	-15.360
15 - 19	-31.076	-17.624	-13.452
20 - 24	-84.070	-38.681	-45.389
25 - 29	-109.508	-50.726	-58.782
30 - 34	-76.786	-38.129	-38.657
35 - 39	-49.169	-26.687	-22.482
40 - 44	-28.841	-16.567	-12.274

Shënim: vlerat negative tregojnë emigracionin për një grupmoshë dhe gjini të caktuar, kurse vlerat pozitive tregojnë imigracionin; shkalla e vdekshmërisë për grupmoshat më të vjetra është shumë e vështirë për t'u përcaktuar (shih Migracioni në Shqipëri 2004), për rrjedhojë, imigracioni i dukshëm për grupmoshat më të vjetra mund të jetë i pasaktë.

Figura 20 dhe Figura 21 tregojnë qartë se emigracioni është dukuri e zakonshme në Shqipëri. Ato tregojnë numrin e përlllogaritur të emigrantëve, sipas gjinisë dhe moshës. Burrat janë në përgjithësi më të prirur të largohen nga vendi, sesa gratë, por diferenca nuk është e madhe. Kjo situatë është qartësisht e kundërt me strukturat e emigracionit të vëna


re në të kaluarën, kur burrat ishin shumë herë më të prirur të emigronin, sesa gratë (Figura 21). Ashtu siç është vënë re për migracionin e brendshëm, të rinjtë adult janë ata që kanë më shumë të ngjarë të lëvizin. Kjo sugjeron se migracioni i brendshëm dhe emigracioni mund të jenë dy anë të së njëjtës medalje. Në disa raste, migracioni i brendshëm – lëvizja në një zonë tjetër të Shqipërisë – duket se është i mjaftueshëm për të përmbushur aspiratat individuale. Në raste të tjera, individit mund të zgjedhë një destinacion jashtë vendit, për të ndjekur aspirata të ngjashme. Në të dyja rastet, mundësitë e individit për të lëvizur janë faktorë të rëndësishëm kufizues. Një emigrant i mundshëm mund të përfundojë duke lëvizur në një pjesë tjetër të Shqipërisë, nëse ai/ajo nuk ka burime financiare të mjaftueshme apo një rrjet personal.

Figura 21a: Piramida e popullsisë së emigrantëve, 1989 – 2001



Shënim: 1989-2001; numri i emigrantëve në moshën 85 vjeç e lart nuk përfshihet, për ta bërë interpretimin më të thjeshtë. Për grupmoshat më të vjetra është shumë e vështirë për t'u përcaktuar shkalla e vdekshmërisë për rrjedhojë, imigracioni i dukshëm për grupmoshat më të vjetra mund të jetë i pasaktë.

Figura 21b: Piramida e popullsisë së emigrantëve, 2001 – 2011



Shënim: 2001-2011; numri i emigrantëve në moshën 85 vjeç e lart nuk përfshihet, për ta bërë interpretimin më të thjeshtë. Për grupmoshat më të vjetra është shumë e vështirë për t'u përcaktuar shkalla e vdekshmërisë për rrjedhojë, imigracioni i dukshëm për grupmoshat më të vjetra mund të jetë i pasaktë.

Në raportin e projeksionit të vitit 2011 është përdorur një qasje paksa e ndryshme, qëllimi i së cilës është të parashikojë rritjen e popullsisë së Shqipërisë në vitet në vijim. Diferencat ndodhin pasi raporti i projeksioneve ka lënë jashtë migracionin e kthimit për personat në moshë të vjetër, duke qenë se këto shifra karakterizohen nga një pasiguri e lartë. Fakti që ka dallime pasqyron pasigurinë e projeksioneve dhe metodave të tërthorta, në të cilat hipoteza paksa të ndryshme mund të çojnë në shifra me ndryshime domethënëse. Diferenca të tilla mund të ndodhin nëse shifrat e


censurit korrigjohen, ashtu si në rastin aktual. Këto korrigjime mund të jenë të vlefshme për të përfutur një parashikim disi më të besueshëm, sidomos kur ka të dhëna se shifrat e përdorura për korrigjim janë më të besueshme. Në të gjitha rastet, metoda të ndryshme çojnë në vlerësime të ndryshme, që pasqyrojnë paqartësinë ekzistuese në këto vlerësime. Sa i përket rastit aktual, numri i emigrantëve për periudhën 2001-2011 është llogaritur mbi 480.000 persona.

Strukturat e emigracionit

Numri i konsiderueshëm i emigrantëve ka pasojë të rëndësishme për strukturën e popullsisë në Shqipëri. Me qëllim vlerësimin e ndikimit të emigracionit në periudhën midis viteve 2001 dhe 2011 mbi numrin dhe strukturën e popullsisë shqiptare, kemi përllogaritur një model të evolucionit demografik me dhe pa emigracionin, paraqitur në Figura 22. Një prej pasojave të migracionit ndërkombëtar është një mospërputhje e dukshme midis popullsisë aktuale të të rinjve adult dhe popullsisë së të rinjve adult që do të ekzistonte pa emigracionin. Ngjyrat e çelura të piramidës tregojnë se si kanë kontribuar emigrantët në uljen e popullsisë shqiptare, sipas grupmoshës. Shifrat nxjerrin në pah se jo të gjitha grupmoshat preken në të njëjtën shkallë dhe se më e prekura është popullsia në moshë pune.

Sipas këtyre modeleve, më shumë se 34 përqind e meshkujve kanë emigruar nga popullsia e grupmoshës 25-34 vjeç (Tabela 6 në shtojcë). Në dallim, për grupmoshën 20-24 vjeç, janë 23 përqind meshkuj që kanë emigruar (kundrejt 29 përqind për femrat). Në fakt, strukturat e emigracionit në dekadën e fundit kanë qenë gjerësisht të ekuilibruara në këndvështrimin gjinor, ndërkohë që në periudhën 1989-2001 kishte një mungesë të këtij ekuilibri gjinor (Figura 21a).


Figura 22: Popullsia më 1 tetor 2011 me dhe pa emigracionin



Shënim: me ngjyra të errëta tregohet popullsia aktuale (censusi), ndërsa me ngjyra të çelura numri i emigrantëve të secilës grupmoshë; kombinimi i ngjyrave të çelura dhe të errëta tregon popullsinë që do të ekzistonte pa emigracionin.

Edhe pse ka shumë shqiptarë që emigrojnë, ata priren të vendosen më së shumti në dy vende, krahasuar me të tjerat. Sipas të dhënave të OECD-së, vendet më të preferuara të destinacionit për emigrantët shqiptarë janë Italia dhe Greqia, të ndjekura nga ShBA-ja, Mbretëria e Bashkuar dhe Gjermania. Një numër prej 47 përqind emigrantësh shqiptarë jetojnë në Itali, duke e bërë këtë vend destinacionin më të kërkuar, i ndjekur ngushtë nga Greqia, me 43 përqind të emigrantëve shqiptarë. Në vend të tretë, renditen me diferencë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.


Figura 23: Numri i shqiptarëve jashtë vendit, 2011



Shënim: të dhënat bazohen tek shtetësia, ndërsa për Shtetet e Bashkuara të Amerikës të dhënat bazohen mbi vendlindjen.

Llogaritjet e numrit të shqiptarëve në Greqi ndryshojnë në mënyrë domethënëse, bazuar në mënyrën si përkufizohen të huajt – nënshtetësi e huaj kundrejt të lindurve në vend të huaj – dhe nëse merren parasysh shtetasit e natyralizuar apo shqiptarët si pakicë etnike. Për shembull, në vitin 2011, numëroheshin rreth 450.000 shtetas shqiptarë me vendbanim në Greqi, por vetëm rreth 346.000 individë ishin të lindur në Shqipëri. Një pjesë e madhe e kësaj difference përfshin anëtarët e pakicës shqiptare në Greqi. Të dhënat e Bankës Botërore raportojnë se numri i shqiptarëve në Greqi është rreth 677.000, përfshi shqiptarët etnikë të lindur në Greqi, të cilët nuk kanë nënshtetësi shqiptare. Po kështu, ka 91.000 shqiptarë në Maqedoni, duke pasqyruar shqiptarët më shumë si një minoritet, sesa si emigrantë të rishtë¹.

Figura 24: Flukset dalëse të shqiptarëve drejt vendeve të përzgjedhura të OECD-së, 2005 – 2011



Shënim: të dhënat bazohen tek shtetësia, ndërsa, për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të dhënat bazohen tek vendlindja

Sa u përket flukseve të fundit dalëse, struktura e përgjithshme në periudhën 2005-2011 shënonte një trend në rënie (Figura 24). Në të kundërtën, në vitin 2008, u shënuar një rritje e emigracionit për në Itali dhe një rritje disi më e vogël e emigracionit në Greqi, në vitin 2009. Këto rritje janë pak të papritura, duke pasur parasysh që, në atë kohë, kriza ekonomike kishte nisur tashmë të prekte vendet në fjalë. Pas këtyre rritjeve të përkohshme, flukset e jashtme drejt Italisë dhe Greqisë janë ulur në mënyrë të qëndrueshme. Shkalla e rënies midis vitit 2010 dhe 2011 ishte rreth 40 përqind për Greqinë dhe rreth 25 përqind për Italinë. Flukset e emigracionit drejt Greqisë në vitin 2011 ishin më pak se gjysma e atyre në vitin 2005; Flukset e emigracionit në Itali ishin rreth 60 përqind e atyre që shënoheshin gjashtë vjet më parë.

1. Shënim: nga <http://peoplemov.in>, marrë nga të dhënat e Bankës Botërore; këto të dhëna duket se konsiderojnë gjithashtu shqiptarët etnikë si emigrantë.

Flukset e jashtme drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe vendeve të tjera të OECD-së u prekën më pak në periudhën e trajtuar, por edhe aty vëmë re një prirje në rënie (Figura 41, në shtojcë).


Migracioni i kthimit

Me një popullsi kaq të madhe emigruese është e lehtë të harrosh se ka shqiptarë që kthehen në Shqipëri, pasi kanë kaluar kohë jashtë. Ashtu siç tregohet në Figurën 25, këta të kthyer prirën të jenë relativisht të rinj dhe, qartësisht, në moshë pune. Edhe pse disa prej këtyre individëve kthehen në mënyrë të përhershme në Shqipëri, për shumë prej tyre kthimi ka natyrë të përkohshme (Maroukis dhe Gemi 2013). Në këtë kuptim, migracioni i kthimit i kapur nga censusi është një fotografim i migracionit qarkullues.

Nuk ka shumë të kthyer në moshë pensioni, diçka që mund të pritej, në rast se shqiptarët do të punonin jashtë deri në moshën e pensionit e do të ktheheshin, më pas, në Shqipëri. Duke pasur parasysh se shumë migrantë pune emigrojnë në të njëzetat dhe tridhjetat e tyre, mund të jetë shumë herët për të kapur migracionin e kthimit për personat në moshë pensioni - ata që në vitin 1989 ishin në të njëzetat e tridhjetat e tyre, vetëm tani po i afrohen moshës së pensionit.

Figura 25 bën krahasimin e strukturës moshore të atyre që lëvizin brenda Shqipërisë (migrantë të brendshëm) dhe atyre që kthehen në Shqipëri, pasi kanë kaluar disa kohë jashtë (të kthyerit). Shpërndarja moshore e të kthyerve zhvendoset me rreth 10 vjet krahasuar me shpërndarjen moshore të migrantëve të brendshëm. Për shembull, grupmosha më e zakonshme për ndryshimin e vendbanimit në Shqipëri është 20-24 vjeç. Në dallim, mosha më e zakonshme që kthehet nga jashtë në Shqipëri është 30-34 vjeçe. Trajta e strukturës moshore, sidoqoftë, është më së shumti e njëjtë.


Figura 25: Migrantët e brendshëm dhe migrantët e kthyer sipas grupmoshës, në (%)



Shënim: struktura moshore e migrantëve të brendshëm dhe të kthyerve; grupmosha e parë (0 – 10) mbulon një periudhë prej 10 vjetësh, ndërsa të tjerat mbulojnë një periudhë 5-vjeçare secila.

Sa i përket gjinisë, burrat e kthyer janë dyfish më shumë sesa gratë e kthyer në Shqipëri. Shpërndarja moshore për burrat dhe gratë, sidoqoftë, ka ngjashmëri të dukshme. Duke pasur parasysh se, në përgjithësi, burrat janë më të prirur për të lëvizur për qëllime punësimi, nuk është e pazakontë që raporti i të kthyerve të grupmoshës 25-45 vjeç është më i theksuar për burrat, sesa ajo që mund të shihet në Figurën 25 për dy gjinitë e kombinuara. Nga ana tjetër, shpërndarja për gratë është disi më e sheshtë (Figura 26), duke pasur parasysh se gratë prirën më shumë të lëvizin për arsye familjare (Figura 27). Pavarësisht arsyeve disi të ndryshme për të migruar, kulmi për gratë është po ashtu rreth së njëjtës moshë si burrat.


Figura 26: Numri i migrantëve të kthyer sipas grupmoshës dhe gjinisë



Shënim: grupmosha 0-10 vjeçe është hequr për ta bërë më të thjeshtë interpretimin

Arsyet e kthimit në Shqipëri shqyrtohen më tej në Figurën 27. Në shifra, puna dhe familja janë arsyet mbizotëruese nga të gjitha. Është me rëndësi të theksojmë se kjo vlen si për burrat, ashtu edhe për gratë. Arsyet e studimit luajnë një rol shumë të vogël, edhe pse prekin vetëm një grupmoshë relativisht të kufizuar. Për burrat, arsyeja kryesore e kthimit në Shqipëri është për punë, ndërsa, për gratë, arsyet familjare janë paksa më të rëndësishme. Duke qenë se të kthyerit janë kryesisht burra, numri aktual i burrave që kthehen për arsye familjare është më i lartë se numri i grave që kthehen për të njëjtat arsye.


Figura 27: Arsyet e kthimit, në (%)



Shënim: kategoria e arsyeve të tjera nuk merret në konsideratë në këtë figurë (12 përqind për meshkujt dhe 8 përqind për femrat mes migrantëve të kthyer).


Duke parë nivelin arsimor të të kthyerve, shpërndarja sipas niveleve arsimore ka mbetur relativisht e qëndrueshme gjatë kohës. Të kthyerit me arsim të mesëm përbëjnë pjesën më të madhe, që pasqyron nivelet e përgjithshme të arsimit në Shqipëri. Që prej vitit 2008, raporti i individëve me arsim 7/8/9 vjeçar është rritur (Figura 28). Ky është reflektim i migracionit të kthimit të konsiderueshëm nga Greqia, që prej fillimit të krizës në vitin 2008, siç parashtrohet më poshtë. Në të njëjtën kohë, raporti i individëve me arsim të lartë ka rënë në mënyrë të dukshme. Ky është pasqyrim i numrit të përgjithshëm në rritje të migrantëve që kthehen në Shqipëri; vlerat absolute të të kthyerve me arsim të lartë janë relativisht të qëndrueshme në kohë dhe, në fakt, janë rritur që prej vitit 2008 (Figura 42 në shtojcë).

Figura 28: Migrantët e kthyer sipas nivelit arsimor dhe vitit të kthimit, në (%)



Numri i shqiptarëve që kthehen është rritur ndjeshëm në periudhën midis vitit 2008 dhe 2010 (Figura 29). Në vitin 2011, ky numër arriti nivelin më të lartë se vitet përpara vitit 2008. Ky është pasqyrim i drejtpërdrejtë i krizës ekonomike dhe faktit që individët nuk ishin më në gjendje të vazhdonin projektet e tyre të migracionit në Itali dhe, veçanërisht, në Greqi (Maroukis dhe Gemi 2013). Studime cilësore sugjerojnë se, në fillim të krizës ekonomike, shqiptarët në Greqi bënë përpjekje të qëndronin, por, gjithnjë e më tepër, nuk qenë në gjendje ta bënin këtë. Ata janë kthyer në Shqipëri, por planifikojnë të ri-emigrojnë sapo të dalë mundësia.


Figura 29: Numri i migrantëve të kthyer, 2001 – 2011



Fakti që situata ekonomike në Greqi është faktori mbizotërues i kthimit, më shumë sesa faktori i përfundimit të projektit të tyre të migracionit, shihet edhe në Figurën 30. Duke marrë në konsideratë numrin e të kthyerve sipas vendit, bëhet e dukshme se rritja e migracionit të kthimit në përgjithësi përcaktohet kryesisht nga shqiptarët që kthehen nga Greqia. Rritja e numrit të shqiptarëve që kthehen nga Italia është gjithashtu e dukshme, por jo aq e theksuar sa te shqiptarët që kthehen nga Greqia. Për të vërtetuar se gjendja ekonomike është arsyeja e kthimit, Figura 30 përfshin edhe migracionin e kthimit nga Gjermania, një vend shumë më pak i prekur nga kriza, sesa Greqia dhe Italia. Në të vërtetë, numri i shqiptarëve


që kthehen nga Gjermania ka mbetur i qëndrueshëm gjatë kohës. Këto struktura kthimi janë të njëjta për të gjitha qarqet e Shqipërisë.

Figura 30: Numri i migrantëve të kthyer nga Greqia, Italia, Gjermania sipas vitit të kthimit



Ndërkohë që numri më i madh i të kthyerve vendoset në Tiranë, jo të gjitha qarqet preken në të njëjtën shkallë nga migracioni i kthimit (Figura 31). Duke pasur parasysh marrëdhëniet historikisht të ngushta me Greqinë dhe numrin e madh të migracionit të kthimit në periudhën 2001-2011, nuk është e papritur që Vlorë ka numrin më të madh të të kthyerve. Në ndryshim nga qarku fqinj i Gjirokastrës, Vlorë tërheq edhe një numër të konsiderueshëm të migrantëve të kthyer nga Italia. Vlorë ndryshon edhe nga qarqet e tjera, për faktin se shumica e shqiptarëve të kthyer në Vlorë në periudhën 2001-2011 e kishin vendbanimin e zakonshëm në vitin 2001 jashtë Shqipërisë (Figura 31).


Figura 31: Migrantët e kthyer sipas vendbanimit të zakonshëm në vitin 2001, në (%)



Shënim: vendbanimi i zakonshëm në vitin 2001 i shqiptarëve që janë kthyer në periudhën 2001-2011, sipas qarkut.

Kjo tregon se shumica prej tyre kanë qëndruar jashtë për më shumë sesa një dekadë përpara se të ktheheshin. Në qarqet e tjera, shumica e të kthyerve e kanë patur vendbanimin në Shqipëri në vitin 2001. Shqiptarët që kthehen nga Italia përqëndrohen kryesisht vetëm në dy qarqe, Durrës dhe Shkodër. Lezha, gjithashtu, tërheq një numër të konsiderueshëm shqiptarësh që kthehen nga Italia, por numri i atyre që kthehen nga Greqia mbetet më i madh se i të parëve, ashtu si edhe në qarqet e tjera.

Harta 7: Migrantët e kthyer sipas qarkut dhe vendit të emigrimit



Shënim: nuancat e së gjelbrës japin përqindjen e popullsisë së të kthyerve, ndërsa grafiku tregon vendet e emigrimit (Greqi, Itali, të tjera) në secilin qark.


Të huajt në Shqipëri

Një aspekt i ndryshëm i migracionit është fakti që në Shqipëri jetojnë edhe shtetas jo shqiptarë. Sidoqoftë, në Shqipëri ka vetëm një popullsi të vogël të huajsh dhe tabloja është e ngjashme, si në rastin e shtetasit të huaj ashtu edhe të individëve të lindur jashtë vendit. Në përgjithësi, në vitin 2011, në Shqipëri numëroheshin 51.345 individë të lindur jashtë dhe 28.309 shtetas të huaj. Kjo përkon me 1 përqind (të lindur të huaj) dhe 1,8 përqind (shtetas të huaj) të popullsisë banuese. Popullsia e lindur jashtë përbëhet nga 51 përqind meshkuj dhe 49 përqind femra, ndërsa për shtetasit e huaj, raporti i meshkujve është dukshëm më i lartë se i femrave (62 përqind meshkuj).

Fakti që Greqia dhe Italia janë vendet destinacion më të rëndësishme për emigrantët shqiptarë, reflektohet qartë në përbërjen e popullsisë me vendlindje jashtë vendit. Grekët dhe Italianët përbëjnë, deri më sot, grupet më të mëdha në numër të të huajve. Disa prej tyre kanë lindur nga prindër shqiptarë, të cilët jetonin jashtë në atë kohë. Ndodh që disa prindër shkojnë në spitale në Itali dhe Greqi që t'i lindin fëmijët atje, qoftë për shkak të perceptimit se ka standarde më të larta mjekësore dhe për shkak të një avantazhi – faktik ose të perceptuar – se fëmijët mund të marrin më lehtësisht nënshtetësinë greke ose italiane. Shifrat në census tregojnë se kjo është dukuri e kufizuar, duke gjykuar nga numri i vogël i përgjithshëm i vendbanuesve me vendlindje jashtë vendit.

Figura 32 tregon se shumica e të huajve në Shqipëri janë të rinj, të lindur pas vitit 1989. Në fakt, shifrat tregojnë se, përpara vitit 1989, migracioni nga dhe drejt Shqipërisë ishte mjaft i kufizuar. Shpërndarja moshore reflekton një numër më të lartë shqiptarësh në Itali dhe Greqi gjatë kësaj kohe, edhe pse duket se situata ka mbetur e pandryshuar gjatë pesë viteve të fundit në Itali. Për individët e lindur në Greqi, ka një numër relativisht të dallueshëm personash në moshë të vjetër. Ky numër mund të reflektojë thjesht migracionin ndërkufitar midis jugut të Shqipërisë dhe Greqisë. Struktura moshore e banorëve të lindur jashtë është kryesisht e njëjtë për burrat dhe gratë (Figura 43 në shtojcë).

Figura 32: Shtetasit e lindur jashtë vendit sipas grupmoshës




4. NDIKIMI I MIGRACIONIT

Në kapitujt paraardhës shihet se migracioni ka vazhduar të ndikojë në numrin dhe strukturën e popullsisë në Shqipëri gjatë dekadës së fundit. Shumë shqiptarë e kanë ndryshuar vendbanimin e zakonshëm në Shqipëri – migrantët e brendshëm – ndërsa një numër i konsiderueshëm shqiptarësh kanë kërkuar mundësi më të mira jashtë vendit. Në kontekstin e përshkrimit të flukseve migratore, ndikimi demografik u vu në pah në disa vende, si në rastin kur u pa që mbi 40 përqind e burrave shqiptarë midis moshës 25 dhe 34 vjeç janë me qëndrim jashtë vendit (Figura 22). Kjo ka një ndikim të drejtpërdrejtë mbi forcën e punës dhe koeficientin e varësisë në Shqipëri. Ky kapitull fillon me një vështrim nga afër të dërgesave në para nga jashtë, që janë rrjedhojë e drejtpërdrejtë e shumë shqiptarëve që jetojnë e punojnë jashtë. Një vështrim më i ngushtë i gjashtë komunave përreth Tiranës tregon ndikimin e migracionit të brendshëm, ndërsa dy seksione përqendrohen te fëmijët dhe varfëria më në përgjithësi, duke i parë në lidhje me migracionin.

Dërgesa në para nga jashtë vendit

Me mbi një milion shqiptarë që jetojnë jashtë vendit, nuk është çudi që, qoftë studiuesit, ashtu edhe politika i kushtojnë një vëmendje në rritje rolit të këtyre emigrantëve. Shumë emigrantë kryejnë dërgesa në para nga jashtë, të cilat kanë ndikim të menjëhershëm mbi të ardhurat e disponueshme të anëtarëve të familjes që janë lënë pas. Në të vërtetë, dërgesat në para nga jashtë janë konsideruar faktor kryesor i rritjes së shpenzimeve të konsumit në Shqipëri dhe konsiderohen gjerësisht se i kanë dhënë nxitje sektorit të ndërtimit në vend. Figura 33 tregon se vlera e përgjithshme e dërgesave në para nga jashtë që dërgohet në Shqipëri është rritur në mënyrë të qëndrueshme në periudhën midis viteve 2001 dhe 2008. Në vija të trasha, kjo rritje duket se përkon me numrin e shtuar të emigrantëve shqiptarë. Vlera më e lartë e dërgesave në para nga jashtë të regjistruara ishte në vitin 2008, me 1.495 milionë dollarë amerikanë. Kjo shumë është e barasvlershme me 11,5 përqind të PBB-së vjetorë për vitin në fjalë, duke nxjerrë në pah rolin e rëndësishëm që luajnë flukset e dërgesave në para nga jashtë në ekonominë shqiptare.


Figura 33: Dërgesat në para nga jashtë vendit, 1992 – 2013, në milionë dollarë amerikanë



Burimi: Banka Botërore: Të dhënat për Migracionin dhe Dërgesat në para nga jashtë (përditësuar në janar 2014).

Gjatë së njëjtës periudhë, Shqipëria përjetoi një rritje të konsiderueshme dhe të pandërprerë ekonomike, me një mesatare prej 5,9 përqind në vit (2003 – 2008). Në prag të Krizës së Madhe, siç ilustron Figura 33, është e qartë që fluksi i dërgesave në para nga jashtë është ulur. Kjo lidhet drejtpërdrejt me gjendjen ekonomike në Greqi dhe Itali, dy vende që zënë pjesën më të madhe të dërgesave në para nga jashtë. Figura 34 ilustron se Greqia dhe Italia, së bashku, përbëjnë 85 përqind të dërgesave në para nga jashtë. Kjo krahasohet me rreth 85 përqind të numrit të emigrantëve në këto dy vende.


Figura 34: Dërgesat në para nga jashtë në 2011 sipas vendit të emigrimit, në (%)



Burimi: Banka Botërore

Nëse përdorim të dhënat mbi dërgesat në para nga jashtë nga Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (AMNJ) 2012, mund të përshkruajmë fluksin e dërgesave në para nga jashtë nga këndvështrimi i njësive ekonomike familjare që i kanë marrë ato. NjEF-të u pyetën lidhur me anëtarët e tyre që ishin aktualisht jashtë, për të marrë informacion mbi situatën e punësimit, dërgesa në para nga jashtë dhe disa karakteristika demografike. Ashtu siç ilustron Figura 35, rreth 46 përqind e emigrantëve aktualë kryejnë dërgesa në para nga jashtë në shtëpi, pjesa më e madhe në para (35 përqind), por edhe në natyrë ose në të dyja format. Shifrat përkojnë edhe me statusin e punësimit, duke qenë se emigrantët aktualë të punësuar përbëjnë 66 përqind.

Figura 35: Fluksi i dërgesave në para nga jashtë në NjEF gjatë vitit 2012 dhe statusi i punësimit i emigrantëve aktualë, në (%)



Të dhëna nga AMNJ 2012 tregojnë se dërgesat në para nga jashtë përdoren për shpenzime dhe një pjesë e vogël i kushtohet përdorimit për dërguesin e dërgesave në para nga jashtë. Vetëm 3 përqind e emigrantëve që jetojnë jashtë aktualisht duket se dërgojnë para për përdorime vetjake (sipas deklarimit të NjEF-së). Kur bëhet fjalë për mënyrën sesi përdoren këto dërgesa në para nga jashtë që dërguesi i dërgon për përdorim vetjak në Shqipëri, afro 80 përqind e parave investohet në ndërtim, ndërsa 16 përqind në hapjen e një biznesi. Këto vlerësime përkrijnë me studime të tjera që raportojnë se 10 deri në 12 përqind e dërgesave në para nga jashtë investohen, në vend që të shkojnë për shpenzime

familjare (AMNJ 2002, ETF 2007, de Zwagger dhe të tjerët, 2010). Me kaq shumë para të investuara në prona, është e lehtë të kuptohet përse dërgesat në para nga jashtë dhe sektori i ndërtimit shihen si të lidhur ngushtë në Shqipëri. Këto janë forma investimi në të cilat dërgesat në para nga jashtë i shtohen zhvillimit afatgjatë në një formë të caktuar, në kuptimin që thuajse të gjitha paratë investohen në produkte që janë potencialisht të qëndrueshme, në dallim nga shpenzimi i drejtpërdrejtë për konsum. Por, nga ana tjetër, me shifrat e paraqitura këtu është e pamundur të përcaktojmë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e investimeve të ndërmarra. Një ndërtesë e re në vendndodhjen e gabuar mund të mbetet e papërdorur e, për rrjedhojë, të mos i ofrojë asnjë kontribut të qëndrueshëm vendit. Në dallim nga kjo, investimet në ndërtesa ku jetojnë anëtarët e NJEF-së pasqyrojnë përmirësim të nivelit të jetesës, çka përbën kontribut të qëndrueshëm për NJEF-në dhe, më gjerë, për vendin. Për shembull, investimet në instalime hidrosanitare sjellin përfitime të drejtpërdrejta për shëndetin e NJEF-së, që, tërthorazi, janë përfitim për vendin, duke i mbajtur kostot e kujdesit shëndetësor të ulëta.

Fokusi në Tiranë

Edhe pse dërgesat në para nga jashtë luajnë një rol të rëndësishëm në Shqipëri, ka edhe shumë migrantë që lëvizin brenda Shqipërisë. Tirana tërheq numrin më të madh të këtyre migrantëve të brendshëm dhe, ketu do të përqendrohemi në gjashtë komunat përreth Tiranës, (Harta 3). Ndryshimet demografike të përshkruara në kapitullin mbi migracionin e brendshëm kanë pasur pasoja më të mëdha, por, përgjithësisht, gjashtë komunat ngajnë me vendbanimet tipike urbane në Shqipëri. Për shembull, sa i përket arsimit, popullsia në gjashtë komunat rreth Tiranës nuk ka ndryshim domethënës nga mesatarja në shkallë vendi. Me një shifër prej dy përqind analfabetësh, këto zona janë disi më mirë sesa mesatarja në shkallë vendi, që është tre përqind. Ashtu si në zona të tjera, shumica e popullsisë ka kryer arsimin fillor ose të mesëm të ulët, çka tregon se tregu i punës në gjashtë komunat rreth Tiranës nuk është rrënjësisht i ndryshëm nga zona të tjera urbane të Shqipërisë. Ky këndvështrim mbështetet nga fakti se, duke pasur 10 përqind të diplomuar universitarë, gjashtë komunat rreth Tiranës përputhen me mesataren e vendit. Nga ana tjetër, brenda këtyre komunave ka grupime të dukshme dhe 90 përqind e të diplomuarve universitarë në gjashtë komunat e marra në shqyrtim jetojnë në Kashar dhe Farkë.

Tabela 3: Ndjekja e shkollës dhe alfabetizmi

	Nuk e kanë frekuentuar kurrë shkollën		Diploma më e lartë e përfutur				
	Alfabetë	Analfabetë	Pa diplomë	Fillore	E mesme e ulët	E mesme e lartë	Universitare dhe e thelluar
Bërçullë	1,1	1,7	0,9	16,7	54,0	20,9	4,7
Dajt	1,3	1,6	1,3	13,8	36,1	32,2	13,7
Farkë	1,4	1,3	0,8	12,7	29,5	32,5	21,7
Kamëz	1,5	2,1	0,9	18,0	47,8	24,6	5,1
Kashar	1,4	1,1	1,1	12,4	32,3	35,8	15,9
Paskuqan	1,4	2,0	1,0	17,2	49,1	24,6	4,7
Tiranë	1,6	1,3	0,9	9,7	20,7	38,7	27,0

Shënim: ndjekja e shkollës, alfabetizmi dhe arsimimi në Tiranë dhe gjashtë komunat/bashkitë rreth saj, në (%) ndaj popullsisë respektive të tyre.

Më lart, kemi vënë re mbizotërimin relativ të grupmoshave të reja në gjashtë komunat rreth Tiranës. Gjatë dekadës së fundit, një e katërta e popullsisë i përkiste grupmoshës 0 – 14 vjeç. Kjo është dukshëm më e lartë sesa për qytetin e Tiranës, që ka 17 përqind të popullsisë në këtë grupmoshë dhe tregon normë lindshmërie më të lartë në komunat rreth Tiranës ose në NJEF-të migruese me fëmijë të vegjël. Është interesante, gjithashtu, të vërejmë se numri i njësive ekonomike familjare me një prind është relativisht i lartë në zonat e marra në shqyrtim, sidomos në Kamëz (3.485 persona ose 1.116 bërthama familjare), e ndjekur nga Paskuqani dhe Kashari.

Tabela 4: NjEF-të me një prind, në (%)

	NjEF-të me një prind
Bërxaullë	6,1
Dajt	7,4
Farkë	6,5
Kamëz	8,1
Kashar	7,1
Paskuqan	8,1
Tiranë	9,9

Shënim: përqindja e bërthamave familjare që janë njësi ekonomike familjare me një prind, sipas komunës, mesatarja kombëtare 9%.

90 përqind e NjEF-ve në gjashtë komunat rreth Tiranës deklarojnë se jetojnë në pronën e tyre. Kjo shifër përfshin ata që e zotërojnë ligjërisht pronën dhe ata që janë në proces legalizimi të pronës së tyre. Numri në fjalë është saktësisht i njëjtë në mbarë Shqipërinë, ku 90 përqind e popullsisë zotëron pronën e vet. Në shumë raste, dërgesat në para nga anëtarët e NjEF-së jashtë vendit kanë kontribuar në marrjen e pronës së banesës ose kanë ndihmuar për rritjen e standardeve të jetesës duke përmirësuar pronën. Furnizimi me ujë të rrjedhshëm është indikator kyç i standardeve të jetesës në strehim. Në gjashtë komunat rreth Tiranës, thuajse të gjitha NjEF-të kanë ujë të rrjedhshëm, por 3 përqind nuk kanë ujë në pronën e tyre. Kjo krahasohet me 2,6 përqind të NjEF-ve pa ujë të rrjedhshëm në të gjithë Shqipërinë dhe 0,9 përqind të NjEF-ve pa ujë të rrjedhshëm në qendër të Tiranës. Nëse marrim në konsideratë furnizimin me ujë jo nga tubacioni, 19 përqind e NjEF-ve në gjashtë zonat rreth Tiranës kanë mungesë furnizimi të mjaftueshëm me ujë. Kjo shifër krahasohet me 11,2 përqind të NjEF-ve në të gjithë Shqipërinë dhe nxjerr në pah se urbanizimi në vetvete nuk u jep fund kushteve të varfra të jetesës për të gjithë. Në fakt, duke parë përqindjen e NjEF-ve pa tualet, është e qartë se niveli i ulët i higjienës në gjashtë komunat rreth Tiranës ekziston ende me 0.4 përqind të NjEF-ve që nuk kanë tualet dhe 4 përqind të tyre që kanë lloje “të tjera” tualetesh.


Fëmijët dhe ndikimi social i migracionit

Analizat në këtë raport konfirmojnë se NjEF-të luajnë rol të rëndësishëm në migracionin shqiptar. Nëse përdorim të dhëna nga AMNJ 2012, mund të përftojme një tablo më të mirë të emigrantëve, duke pasur parasysh se anëtarëve të NjEF-së në Shqipëri iu kërkohet t’iu përgjigjen pyetjeve jo vetëm rreth anëtarëve të NjEF-të që banojnë aktualisht aty, por edhe për anëtarët e NjEF-të jashtë vendit. Natyrisht, këto shifra nuk mund të përfshijnë NjEF-të, të cilat jetojnë tërësisht jashtë vendit, por mund të ofrojnë një orientim më të mirë lidhur me ndikimin social të migracionit, sesa vetëm të dhënat e censurit.

Nga të gjitha NjEF-të që deklarojnë se kanë migrantë të brendshëm në NjEF-të e tyre, rreth gjysma pohojnë se kanë të paktën tre pjesëtarë që janë zhvendosur në një zonë tjetër të Shqipërisë (Tabela 5 në shtojcë). Kjo tregon se, në shumë raste, migracioni i brendshëm ndodh si njësi familjare ose njësi nën-familjare, që përbëhet nga disa anëtarë të NjEF-së. Në të vërtetë, kur shohim shifrat të zbërthyera sipas gjinisë, në 92 përqind të rasteve të përshkruara kanë lëvizur si anëtarët meshkuj, ashtu edhe ato femra, të njësisë familjare. Në 6 përqind të këtyre rasteve, kanë lëvizur vetëm anëtarët femra të njësisë familjare; në 2 përqind të rasteve janë vetëm meshkujt ata që kanë lëvizur. Kjo gjetje përkon me mungesën e dallimeve domethënëse gjinore, që përmenden më lart në seksionin mbi migracionin e brendshëm.

